



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

## **RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në**

**“Asistencë Dentare”**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

1. Prof.Asc. Alketa Qafmolla

2. Prof.Asc. Silvana Bara

Shkurt/ 2024

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për programin e studimit me karakter profesional në “Asistencë Dentare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aldent”**

|     |   |  |
|-----|---|--|
| Nr. |   |  |
| 1   | IAL aplikues:   | Universiteti “Aldent”  |
| 2   | Njësia bazë që e ofron:                                       | Departamenti i Laborantëve Dentarë                                   |
| 3   | Emërtimi i programit të studimit:                             | Program me karakter profesional në “Asistencë dentare”               |
| 4   | Urdhëri/VKM i licencimit:                                     | UMAS Nr. 256, datë 19.07.2021  |
| 5   | Urdhëri/VKM i riorganizimit:                                  | -  |
| 6   | Forma e regjistrimit të diplomës:                             | Program i ri   |
| 7   | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:                            | -  |
| 8   | Cikli i studimit:   | Cikli i parë   |
| 9   | Kohëzgjatja e programit të studimit:                          | 2 vite   |
| 10  | Kreditet në total (ECTS):                                     | 120 ECTS   |
| 11  | Forma e studimit:   | Me kohë të plotë   |
| 12  | Gjuha (shqip/tjetër):   | Shqip  |
| 13  | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:     | -  |
| 14  | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):                       | -  |
| 15  | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):                         | -  |
| 16  | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:                | Niveli 5   |
| 17  | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: (v.a 22- 23) | 11 PAE/ 5 PAK  |
| 18  | Numri i studentëve:   | 2021-2022: 28 studentë<br>2022-2023: 18 studentë<br>Tot: 46 studentë |
| 19  | Komente / të tjera:   | -  |

## **PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi se programi i studimit me karakter profesional në "Asistencë Dentare" ofrohet nga Fakulteti i Shkencave Dentare (FSHMD), Departamenti Laborantëve Dentarë. Ky program ishte miratuar me vendim të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, urdhëri Nr. 256 në datën 19.07.2021 për "Hapjen e programit të studimit të dy vjeçar me karakter profesional në "Asistencë dentare" të Univesitetit ALDENT dhe i nënshtrohej për të parën herë procesit të akreditimit.

Programi në "Asistencë Dentare" ka nisur funksionimin e tij në vitin akademik 2021-2022. Programi ofronte njohuri me karakter profesional për asistentët dentarë, duke i përgatitur ata profesionalisht për të punuar në klinikat dentare. Në përfundim të formimit të tyre ata janë të aftë të asistojnë në procedura të shumta dentare si protezimi, endodoncia, higjienizimi, ortodoncia, kirurgjia orale dhe implantologjia. Ata kishin njohuri shumë të mira të instrumentariumit dhe materialeve dentare më bashkëkohore sot për sot në fushën e dentistrisë. Për të kuptuar mbi baza shkencore protokollat që ndiqen në klinikë si dhe një informacion të rëndësishëm mbi strukturat anatomike dhe fiziologjinë e organizmit të njeriut, studentët formohen paraprakisht konform planit mësimor të vitit të parë në module si "Anatomia Topografike", "Higjiene dhe Profilaksi" dhe "Mikrobiologji", "Histologji", "Biologji", "Etikë dhe Deontologji", të cilat mundësojnë njohuri thelbësore për një asistim profesional dhe të një standarti të lartë. Modulet e mëtejshme si "Praktikë Profesionale" apo "Dentistri Restorative" "Protetikë Stomatologjike pajisin studentët me njohuri e aftësi praktike në asistimin në mënyrë eficiente, menaxhimin e rasteve klinikë, përgatitjen e sallës operatore sipas disipline, procedurat higjienizimit të etj, duke krijuar një raport 50/50 të kohës ndërmjet teorisë dhe praktikës gjatë vitit të parë.

Gjatë vitit të dytë të studimeve modulet "Kirurgji orale dhe Implantologji" apo "Protetikë Stomatologjike" janë më shumë të orientuara nga klinika dhe praktika mësimore, ku studentët aftësohen në asistimin e ndërhyrjeve kirurgjikale, instrumentariumet specifike për disipinat, ruajtjen e kushteve të asepsise, dhe gjithashtu në rastet e ndryshme të protezimit, aftësim në përdorimin korrekt të materialeve të ndryshme të masave dhe ndërveprim profesional me laboratorët dentarë.

Këto punime dentare përfaqësonin rreth 60% të atyre që ofrohen në dentistri brenda dhe jashtë vendit. Për zhvillimin e mëtejshëm profesional të këtyre specialistëve ofrohen kurse të mëtejshme formimi, në të cilat ata marrin njohuri të përditësuara.

Programi është mjaft i kërkuar nga tregu i punës, jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë tij dhe eksperiencat e para treguan punësim gati 100% dhe nevojë në rritje për këta specialistë.

Programi i studimit me karakter profesional në "Asistencë dentare" është i ri, i licencuar në vitin 2021, dhe akreditohet për herë të parë. Institucioni ka aplikuar për akreditimin e tij në përputhje me procedurat e vendosura nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë të Shqipërisë dhe bazuar në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM Nr. 824, datë 24.12.2021.



## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhet nga Prof.Asc. Alketa Qafmolla dhe Prof.Asc.Silvana Bara.

Grupi i vlerësimit të jashtëm ka vënë në dispozicion të gjithë dokumentacion e nevojshëm të paraqitur nga ASCAL për univesitetin aplikues për akreditim. GVJ u njoh me programin e studimit profesional në ciklin 2 vjeçar të studimit dhe hartimin e RVB, pedagogët hartues, lëndët dhe syllabuset.

Grupi realizoi vizitën në institucion, ku u njoh me infrastruktuën dhe materialet laboratorike të vëna në shërbim të studentëve, u njoh me pedagogët mjekë dhe pedagogët laborantë, u njoh me procedurat e rekrutimit të tyre, si dhe u sqaruan një sërë pyetjesh që grupi pati lidhur me kriteret dhe standardet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve. Një vëmëndje e veçantë, iu kushtua edhe takimit me studentë të vitit të parë dhe të vitit të dytë të programit që është në proces akreditimi. GVJ u njoh me aktivitetet e tyre të organizuara nga institucioni.

Universiteti “Aldent” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucioneve të arsimit të lartë, ndërkombëtare dhe vendase si; Fakulteti i Mjekësisë Dentare/ Universiteti i Mjekësisë i Tiranës etj, në funksion të bashkëpunimit në fushën e shkëmbimeve akademike etj. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivave të procesit mësimor, universiteti ka shtuar përpjekjet për të krijuar lidhjet e duhura me institucione të ndryshme. Për realizimin dhe përmirësimin e programit universiteti ka marrëveshje edhe me qendra të mëdha dentare në vend dhe kryerjen e praktikave profesionale. Numri i madh i institucioneve partnere dhe aktiviteti i shtuar, kanë dhënë rezultate të kënaqshme në formimin e studentëve dhe përmbushjen e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.

Më datë 22.01.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 47/1 Prot., datë 22.01.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti “Aldent” kthehu përgjigje në AMS më datë 24.01.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 05 Prot., datë 23.01.2023.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.

## Vlerësimi i programit të studimit me karakter profesional në “Asistencë Dentare”

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| <b>Standardi I.1</b>  |   |
|---|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.  | Universiteti “Aldent” kryen veprimtarinë dhe aktivitetin e saj në përputhje me ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje me të kishte rishikuar të gjitha aktet normative të tij.<br>Programi i studimit me karakter profesional në “Asistencë dentare” ishte miratuar me vendim të MASR Nr.256 në datën 19.07.2021. Programi ofrohet në përputhje të plotë me interesat kombëtare të vendit, Statutin e saj si dhe rregulloren e programit të studimit. Synimi i tij është arsimimi dhe kualifikimi profesional i studentëve në fushën e asistencës dentare, materialeve dentare, duke kontribuar në këtë mënyrë në konsolidimin e dentistrisë në nivel kombëtar.<br><i>Vizita në institucion, Takimi me Drejtuesit, Ev.3.Statuti i Universitetit Aldent</i> |
| <b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.   | Programi i studimit me karakter profesional në “Asistencë dentare” është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të Universitetit “Aldent”. Në vizionin e Universitetit “Aldent” përveç realizimit me sukses dhe përmirësimit të vazhdueshëm cilësor të programeve ekzistuese të studimit të fokusuar vetëm në fushat mjekësore, dhe programi i ri profesional në “Asistencë dentare” është në përputhje me zhvillimet në fushën e dentistrisë dhe kërkesave e nevojave të tregut në vendin tonë dhe më gjerë.<br><i>Vizita në institucion, Takimi me Drejtuesit.</i>   |
| <b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.   | Universitetit “Aldent” ka eksperiencë të gjatë që prej vitit 2003 në fushën e edukimit për programet mjekësore duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin me njohuritë bashkëkohore në të gjitha programet që ofron. Formimi i këtyre specialistëve në teknikat, aparaturat, instrumentet dhe materialet më bashkëkohore, ju mundësojnë që në bashkëpunim me mjekun stomatolog, të ofrojnë aftësim të mëtejshëm dhe njohje e trajnim për problematika me të cilat ata do të përballëshin gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Programi synon të aftësojë studentët praktikisht në asistimin në disiplina të ndryshme të dentistrisë konform fushës së aktivitetit akademik të institucionit.<br><br><i>Vizita në institucion, Takimi me Drejtuesit. Ev 5 : Strategjia e UAL</i>   |
| <b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit   | Programi i studimit është hartuar duke u bazuar në nevojat në rritje  |




|   |   |
|---|---|
| <p>hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>  | <p>të asistentëve dentare në Shqipëri në kushtet e rritjes së turizmit dentar dhe kujdesit për shëndetin oral në vend duke nxitur kështu edhe zhvillimin lokal e kombëtar të vendit. Në propozimin për hapjen e programit të studimit në “Asistencë Dentare”, janë marrë në konsideratë objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare të zhvillimit, si dhe janë realizuar studime tregu ku janë marrë informacione e është tërhequr mendimi i të gjithë aktorëve si stafi akademik, partnere brenda dhe jashtë vendit që ofrojnë programe të ngjashme, shoqata e urdhëra dentare dhe specialistë të fushës. Programi i hartuar synon të aftësojë në teknikat bazë asistentët dentare, brenda një periudhe 2-vjeçare, pavarësisht rezultateve të arritura në shkollën e mesme, për tju ofruar atyre punësim dhe tregut dentar staf që të plotësojnë nevojat dhe mungesat në tregun e punës. Gjithashtu, për të realizuar objektivin e mësipërm, qëllimin dhe misionin e programit të studimit, vend të rëndësishëm luajnë edhe bashkëpunimet me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit të cilat kanë si qëllim sfidat në sistemin shëndetësor dentar, si dhe veprimtari dhe diskutime që lidhen me zhvillimin në fushën e dentistrisë etj.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>  | <p>Universiteti “Aldent” ndër vite ka arritur të ketë një profil të qëndrueshëm dhe të besueshëm të një institucioni i cili në historikun e vet mbarë disa arritje të rëndësishme të cilat shërbejnë si garanci për zhvillimin e mëtejshëm të saj për vitet në vijim. Periudha 20 vjeçare gjatë së cilës institucioni ka shërbyer si qendër e formimit për shkencat mjekësore ka bërë të mundur konsolidimin e një përvoje të fortë në të gjithë aspektet e mësimdhënies, infrastrukturës e burimeve njerëzore të nevojshme për ofrimin e një programi studimi. Kështu, institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme logjistike dhe didaktike për zhvillimin e programit të studimit në “Asistencë Dentare” siç janë sallat e leksioneve, seminareve, biblioteka dhe laboratorët e klinikat, të mirëpajisura me teknikat bashkëkohore dentare.</p>   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> | <p>Fusha e programit të studimit në “Asistencë Dentare” me atë të Fakultetit të Shkencave Dentare është në përputhje me fushën e përgjithshme të programit të studimit e cila përfshin arsimimin dhe kualifikimin profesional të studentëve në fushën e stomatologjisë, teknikave dentare digjitale dhe materialeve dentare, gjithashtu të programeve të studimit e direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët.</i></p>   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Universitetit “ALDENT” ushtron veprimtarinë dhe aktivitetin e saj në përputhje me ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij dhe në përputhje</i></p>   |



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>me të ka rishikuar të gjitha aktet normative të tij. Programi i studimit me karakter profesional në "Asistencë Dentare" është hartuar në përputhje dhe në zbatim të misionit dhe qëllimit të Universitetit "ALDENT". Universiteti ka eksperiencë të gjatë që prej vitit 2003 në fushën e edukimit të shkencave mjekësore, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në formimin me njohuritë bashkëkohore në formimin profesionin e asistentit dentar. Programi i studimit është hartuar duke u bazuar në nevojat në rritje të klinikave dentare në Shqipëri për asistentë dentare në kushtet e rritjes së turizmit dentar dhe kujdesit për shëndetin oral në vend, duke nxitur kështu edhe zhvillimin lokal e kombëtar të vendit. Universitetit "ALDENT" në vite ka arritur të ketë një profil të qëndrueshëm dhe të besueshëm të një institucioni, i cili në historikun e vet mbart disa arritje të rëndësishme që shërbejnë si garanci për zhvillimin e mëtejshëm për vitet në vijim.</p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

#### Standardi I.2

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, dhe mobilitetit.**

| Kriteret   | Vlerësimi  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisive e personelit, marrjes së përgjegjësisive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> | <p>Programet e studimeve në Fakultetin e Shkencave Dentare u referohen arritjeve teorike dhe praktike të shkencave në përgjithësi dhe veçanërisht atyre që lidhen me zhvillimin e teknologjisë digjitale dentare. Zhvillimi i programeve të reja të studimit bëhej në përshtatje me nevojat e shoqërisë, kushtet ekzistuese dhe perspektivave të zhvillimit të vendit. Personeli akademik, ngre një grup pune i cili mbledh informacion dhe harton një program studimi dhe pasi diskuton mbi kompetencat dhe mundësinë e personelit të departamentit, në bashkëpunim edhe me personelin akademik nga brenda dhe jashtë, i miraton këto programe në nivel departamenti. Programi më pas diskutohet në mbledhjen pasardhëse të dekanatit, si organ kolegjal ekzekutiv. Dekanati më pas i paraqet propozimin për hapjen e një programi të ri studimi Senatit akademik. Mbi këtë propozim, ngrihet një grup pune nga senati i cili harton raporte, të cilat më pas diskutohen në mbledhjen e rradhës të Senatit Akademik të universitetit. Pas miratimit në senat, propozimi dërgohet për miratim tek Bordi i Administrimit. Mbarëvajtja e programit sigurohet edhe nëpërmjet anketimeve nga NJSBC, rezultatet e të cilave diskutohen në analizën e punës në Departament dhe merren masat e nevojshme përmirësuese.</p> <p><i>Vizita në institucion, Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët, Ev.7: Tabelat 2)</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e</p>  | <p>Universiteti Aldent ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një</p>   |

|  |  |
|--|--|
| <p>objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>   | <p>numër të konsiderueshëm institucionesh homologe të arsimit të lartë ndërkombetar dhe vendas në funksion të bashkëpunimit në fushën e shkëmbimeve akademike etj. Në zbatim të strategjisë së zhvillimit të institucionit dhe objektivave të procesit mësimor, universiteti ka shtuar përpjekjet për të krijuar lidhjet e duhura me institucione të ndryshme, organizata të huaja dhe kompani prodhuese. Numri i madh i institucioneve partnere dhe aktiviteti i shtuar në fushën e stomatologjisë, kanë dhënë rezultate në formimin e studentëve dhe përmbushjen e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p> | <p>Përveç marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë, lista e marrëveshjeve të Universiteti "Aldent" me homologë dhe institucione të huaja dhe vendase, organizata të huaja, kompani prodhuese dentare që mundesojnë realizimin e praktikave profesionale klinike me fjalën e fundit të materialeve apo teknikave sot për sot. Universtiteti bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, u shërbente studentëve të kishin mundësi të marrin pjesë në organizimin e konferencave të ndryshme apo në programet e mobilitetit, falë marrëveshjeve të bashkëpunimi në kuadër të programeve CEPUS, Erasmus+, marrëveshjeve në të cilat përfshihen shkëmbime të stafit, dhe studentëve të këtij programi duke iu dhënë mundësi të reja studimi për realizimin e praktikave profesionale.</p> <p><i>Vizita në institucion. Takimi me Drejtuesit, stafin, studentët, Ev.22: Marrëveshjet.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>   | <p>Departamenti i Laborantëve Dentar është përgjegjës për mbarëvajtjen e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit cakton grup pune i cili hartonte analizën dhe e paraqet për diskutim në mbledhje departamenti. Në analizën vjetore që zhvillon institucioni, është hartuar raporti i realizimit të programit në të cilin jepet edhe vlerësimi i arritjeve nga marrëveshjet e nënshkuara, evidentimit të rasteve pozitive dhe përfitimit maksimal nga bashkëpunime të frytshme. Njëkohësisht vlerësohet edhe nevoja për gjetjen e bashkëpunitorëve e partnerëve të rinj në fusha specifike të veprimtarisë së institucionit dhe që i shërbejnë personelit akademik dhe studentëve.</p> <p><i>Takimi me, stafin, studentët</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndërmerri iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.</p>  | <p>Universiteti "Aldent" ka nivelin më të lartë të punësimit të studentëve të programeve që ofroheshin nga Fakulteti i Shkencave Dentare. Janë punësuar në profesion mbi 65 % e studentëve të diplomuar në vitet e fundit. Veçanërisht i suksesshëm ka qenë punësimi i tyre në Gjermani, Angli ose vende të tjera evropiane. Në këtë program akoma nuk ka të diplomuar por disa prej studentëve ishin punësuar part time që në vitin e dytë. Marrëveshjet me klinikat dentare në Shqipëri, ku studentët kryejnë praktika profesionale ishin mbështetje për punësim të studentëve të cilët nënshkruajnë kontrata punësimi dhe kanë mundësi punësimi part time edhe gjatë periudhës së studimeve. Personeli</p>  |



|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <p>ndihmës-akademik i jashtëm pranë UAL ka në jo pak raste edhe aktivitetin e tyre privat si klinika apo poliklinika dentare, duke u kthyer në një faktor punësimi të studentëve. Institucioni mban kontakt të vazhdueshëm dhe informon mbi ecurinë e punësimit të studentëve të diplomuar nëpërmjet Zyrës Alumni, duke i mbështetur kështu dhe në jetën post univesitare, me kontakte të shumta punësimi.<br/><i>Takimi me stafin, studentët, Zyrës Alumni.</i></p>  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <p><i>Programet e studimeve në Fakultetin e Shkencave Dentare u referohen arritjeve teorike dhe praktike të shkencave në përgjithësi dhe veçanërisht atyre që lidhen me praktikat bashkëkohore dentare. Universiteti Aldent ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me një numër të konsiderueshëm institucionesh të arsimit të lartë ndërkombetare. Universiteti Aldent ka nivelin më të lartë të punësimit të studentëve. Janë punësuar mbi 65 % e studentëve të diplomuar në vitet e fundit në këtë fakultet dhe disa nga diplomantët e këtij programi studimi. Veçanërisht i suksesshëm ka qenë aplikimi dhe punësimi i tyre në vende europiane.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi I.3

**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | <p>Sipas nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë, pika I, Universiteti Aldent është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësish së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë. Universiteti Aldent funksionon në përputhje të plotë të këtij neni duke patur funksionale Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila harton procedura dhe politika për përmirësimin e cilësisë. Në planin afatshkurtër të zhvillimit, synimi kryesor është garantimi i cilësisë së mësimdhënies në përputhje me Standardet shtetërore dhe Kodin e cilësisë. Përgjatë çdo viti UAL vlerëson performancën e personelit akademik dhe ndihmës akademik në lidhje me zbatimin cilësor të programit të studimit jo vetëm në aspektin e mësimdhënies, por edhe në atë të kërkimit shkencor, kualifikimit dhe kontributit intelektual në institucion sikundër ka zhvilluar analizat e detajuara për vitet paraardhëse.<br/><i>Takimi me, NJSBC, studentët, Ev.6.1: Rregullore Universitetit Aldent.</i></p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion   | Në UAL funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC. Funksionimi dhe operimi i NJSBC rregullohet nga Statuti i   |

|  |   |
|--|---|
| <p>Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>   | <p>UAL dhe Rregullorja e NJSBC, duke patur fokus Strategjinë e Zhvillimit të UAL. NJSBC luan një rol konstruktiv duke bashkëpunuar me njësitë e tjera akademike, administrative dhe studentore. NJSBC organizon rregullisht anketime me studente dhe stafin, kryen analiza dhe i referon. Njësia bazë është përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për përmirësim. Për të krahasuar në mënyrë objektive analizat dhe punën e NJSBC, është lidhur marrëveshja me Institute for Quality in Education (iqe.al) e cila në mënyrë rutinë zhvillonë analizat nëpërmjet anketave dhe pyetësoreve me stafin dhe studentët. Pjesë e analizës së institucionit është vlerësimi për evidentimin e problematikave dhe adresimi për zgjidhjen e tyre si një proces i përmirësimit të vazhdueshëm të institucionit. <i>Takimi me NJSBC dhe studentët, Ev.7 Tabelat, Anëtarët e NJSBC</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p> | <p>Institucioni përdor instrumenta të ndryshme për sigurimin e cilësisë. Një nga metodologjitë standarde ishte kryerja e pyetësorëve të ndryshëm me studentët për stafin akademik, infrastrukturën, programin mësimor për të përmirësuar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Institucioni ka në fokus plotësimin e standardeve shtetërore dhe raportet e vlerësimit të jashtëm, ku bashkëpunimi me ASCAL, ekspertet që angazhohen në proceset e akreditimit, ndihmojnë institucionin të përmirësoj performancën e vet në tregues të ndryshëm të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. <i>Takimi me NJSBC dhe studentët, Ev 21.1.1 Rregullore e NJSBC</i></p>                     |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.</p>                        | <p>Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm. Përveç njësive bazë, NJSBC gjeneron analiza të shoqëruara me të dhëna, të cilat shërbejnë për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta që ka institucioni. NJSBC në bazë të raporteve/analizave jep rekomandimet e saj për nxitjen e praktikave të mira dhe përmirësimin e pikave të dobëta. Kurdoherë NJSBC është e gatshme të asistoj departamentet përkatëse për implementimin ose përmirësimin e praktikave mësimore aktuale. UAL përdor tregues të matshëm për vlerësimin e mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe mangësive. <i>Takimi me, NJSBC dhe studentët, Ev. 21.2, 21.3, 21.1.1 : Pyetësi i stafit, i studentëve, Raporti vjetor i NJSBC</i></p>   |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Në UAL funksionon Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë, NJSBC. Funksionimi dhe operimi i NJSBC rregullohej nga Statuti i UAL dhe Rregullorja e NJSBC, duke patur fokus Strategjinë e Zhvillimit të UAL. Sigurimi i cilësisë është proces i vazhdueshëm. Përveç njësive bazë, NJSBC gjeneron analiza të shoqëruara me të dhëna, të cilat shërbenin për evidentimin e pikave të forta dhe të dobëta që kishte institucioni. NJSBC në bazë të raporteve/analizave jep rekomandimet e saj për nxitjen e praktikave të mira dhe përmirësimin e pikave të dobëta..</i></p>  |

| Shkalla e përmbushjes së standardit              | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|--|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|  |                |                       |                      | X                     |
| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|  |                |                       |                      | X                     |




## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

| <b>Standardi II.1</b>  |  |
|--|--|
| <b>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.</b>   |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>  | <p>Programi i studimit përmbush detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, është në harmoni të plotë me misionin e UAL dhe reflekton të gjitha kërkesat e parashtruara në VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", e ndryshuar dhe shtesat e udhëzimit përkatës dhe praktikat me të mira evropiane. Modulet dhe lëndët janë të vlerësuara në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i organizuar në module, e lëndët janë të kategorizuara mbi bazën e veprimtarive formuese, duke i ndarë ato në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje. Programi i studimit mbështetet në forma të ndryshme mësimdhënie si: leksionet interaktive, seminare, detyra kursi, dhe punë e pavarur e studentëve jashtë auditorit. <i>Takimi me stafin, studentët, Ev: 7 Tabela 10</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.</p> | <p>Programi synon aftësimin profesional të studentëve në fushën e asistencës dentare. Njohuritë që studentët marrin janë të ndryshme si anatomia dhe fiziologjia e gojës, etika profesionale, shëndeti oral, gjuha angleze, dentistria, pedodontia, instrumentariumi, kirurgjia orale etj. Nëpërmjet programit dhe përmbajtjes së moduleve, metodave të mësimdhënies, projekteve dhe detyrave të ndryshme, praktikave synohet që tu japin studentëve njohuri të përparuara akademike dhe shprehje praktike në fushën e dentistrisë dhe teknikave dentare, si dhe të zhvillohet i kuptuari kritik i koncepteve që jepen në teori nëpërmjet aplikimit praktik të tyre në klinikat dentare të UAL. Shpërndarja e orëve është në favor të praktikës në mënyrë që të garantohet zgjidhja e problemeve që lidhen me nivelin, profilin e programit dhe natyrën e punës që parashikohet të kryejë asistenti dentar.</p> <p><i>Ev.16 Konferenca studentore, Ev.15 Aktivitetet ekstrakurrikulare</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>   | <p>Programi i studimit ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale dhe praktike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij. Programi i studimit ka për qëllim krijimin e aftësive specifike në rolin që asistenti dentar ka në një klinikë dentare dhe në disiplinat e ndryshme më të cilat do punoj, zbatimimi më etikë dhe profesionalizëm i detyrave dhe rëndësia e ruajtjes së sekretit profesional.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite</p>   | <p>Programi "Asistencë Dentare" përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41.</p>   |






|  |  |
|--|--|
| <p>për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblyëse.</p>   | <p>datë 24.01.2018 të ndryshuar si dhe aktet nënligjore. Programi i studimit është organizuar sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai realizohet në 2 vite studimi/4 semestra, me 120 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup lënde sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor. Pjesë e planit mësimor është edhe "Praktika Profesionale I dhe II e parashikuar në vitin e dytë të studimeve me 16 kredite në total te cilat shoqërohen me një provim i cili parashikon vlerësimin praktik dhe teorik të studentit. Studenti diplomohet vetëm kur janë shlyer të gjitha detyrimet akademike.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadri ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p> | <p>Universiteti "Aldent" ka hartuar programin e studimit duke iu referuar legjisllacionit përkatës vendas dhe europian. Programi ofrohet me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe. Pranimi i studentëve bëhet në bazë të rregullores së këtij programi studimi si dhe ligjit për arsimin e lartë.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>  | <p>Universiteti "Aldent" ofron program Bachelor në Teknike laborator dentar dhe Master i Shkencave në Stomatologji, të cilat kanë përmbajtje të përafërt pasi janë e fusha të ngjashme studimi. Institucioni merr në konsideratë përmbajtjen e programeve të të njetës fushë e profil. Për hartimin e programit janë bazuar në shembuj të programeve që ofrohen nga institucionet e tjera në vendin tonë dhe ato përendimore.</p> <p><i>Takimi me Drejtuesit.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>  | <p>UAL po punon për kodifikimin e programit (punë në proces) sipas Udhëzimit të MASR Nr. 31, datë 15.11.2022 për "Procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", më aprovimin e udhëzimit lidhur me këtë direktivë. Institucioni kishte gjithashtu një kodifikim të moduleve sipas një rendi të caktuar për secilin program, në sistemin e brendshëm FX të menaxhimit të sekretarisë.</p>  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Programi i studimit përmbush detyrimet ligjore të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të Lartë, është në harmoni të plotë me misionin e UAL. Programi synon aftësimin profesional të studentëve në fushën e asistencës dentare, me kombinim teoriko-praktik në auditore dhe klinikat dentare të UAL.</i></p> <p><i>Programi Asistencë Dentare përmban të gjithë elementet që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit.</i></p> <p><i>Për hartimin e programit janë bazuar në shembuj të programeve që ofrohen nga institucionet e tjera në vend duke retlektuar njëkohësisht edhe specifikat që ka UAL dhe infrastrukturën për ofrimin e programit të studimit.</i></p>                               |

*P. Kullota*

*P. Kullota*



| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|-------------------------------------|----------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     |                |                       |                      |                       |

| Standardi II.2  |   |
|---|---|
| Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.   |   |
| Kriteret  | Vlerësimi   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>  | <p>Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Departamenti i Laborantëve Dentarë janë vlerësuar pozitivisht në procese të tjera akreditimi të programeve të studimit dhe institucional pasi përmbush plotësisht të gjitha detyrimet ligjore të organizimit dhe infrastrukturës akademike që lindin nga ky proces në funksion të arsimit cilësor.</p> <p>Departamenti përbëhet nga 7 staf efektiv nga të cilët: 3 Dr, 2 Msc dhe 2 Mp dhe 9 staf me kontratë nga të cilët: 1 Prof, 2 Dr dhe 6 Msc</p> <p><i>Ev 7, Staf i Departamentit, Tabela 2</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>                                     | <p>Në strategjinë e institucionit , krahas zhvillimit të personelit akademik, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë kualifikimit edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Personeli ndihmës-akademik i angazhuar në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e orëve mësimore të programit dy vjeçar, është i trajnuar dhe kualifikuar nga bashkëpunëtorët e UAL.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Dentare përbëhet nga tre njësi bazë sikurse parashikohet në legjislacionin aktual dhe përmbush të gjitha detyrimet ligjore që lindin nga ky status. Departamenti Laborantëve Dentarë i cili ofron këtë program studimi përbëhet nga 7 staf efektiv. Bazuar në planin mësimor të çdo viti akademik, fakulteti angazhon edhe personel akademik me kohë të pjesshme, por peshën kryesore me mbi 85% e zë personeli akademik efektiv i cili realizon përqindjen më të madhe të ngarkesës totale të programit të studimit.</p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> | <p>Për çdo program studimi, Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e departamentit qoftë nëpërmjet takimeve verbale apo në takime të tjera.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev.9 Strukturat drejtuese organizative (organigrama)</i></p>  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Universiteti Aldent është një institucion me strukturë të mirë organizuar dhe të investuar në mënyrë të tillë që të mundëson eficiencë dhe cilësi në veprimtaritë akademike që zhvillon. Në</i></p>   |

*Refuzo*

*Refuzo*

|                                     |  |                       |                      |                       |
|-------------------------------------|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|                                     | <p>strategjinë e institucionit 2018-2023, krahas edukimit në vazhdim të personelit akademik, institucioni i kushton një rëndësi të veçantë kualifikimit edhe të personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Për çdo program studimi, Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p> |                       |                      |                       |
| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|                                     |  |                       |                      | X                     |

### Standardi II.3

**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>                 | <p>Departamenti i Laborantëve Dentarë është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit, administrimin e veprimtarive akademike dhe koordinimin e brendshëm. Departamenti disponon dosjen e plotë të programit të studimit si dhe është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së programit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të saj.</p> <p>Departamenti dhe personeli akademik bën shpërndarjen e ngarkesës midis lëndëve dhe moduleve si dhe kategorizimin e tyre sipas veprimtarive formuese dhe profilit.</p> <p>Në planet mësimore përfshihet informacioni i nevojshëm me karakter të gjerë informativ dhe praktik. Plani mësimor buron nga kurrikula e programit të studimit dhe pasqyron periudhën kohore të zhvillimit të secilit prej moduleve të programit të studimit në vitin akademik.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev 6.2 Rregullore FSHD</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/ moduleve në kredite, orët në auditor/ jashtë auditorit.</p> | <p>Përmbajtja e programit mësimor reflektohet në planin mësimor i cili paraqet një informacion të detajuar mbi numrin e lëndëve, moduleve, numrin e krediteve, orët në auditor dhe jashtë auditorit, tipet e veprimtarive të parashikuara dhe ngarkesën respektive të tyre në përputhje me VKM 41, dt.24.01.2018 e ndryshuar.</p> <p>Detyrimet akademike që duhet të përmbushë secili student që të klasifikohet në provimin përfundimtar të modulit/ lëndës dhe mënyra e pikëzimit në varësi të ngarkesës është përcaktuar me vendim senati dhe përshkruhet në syllabusin e çdo moduli.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev.7, Plani mësimor, Tabela10, Ev.11 Syllabuset</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të</p>                            | <p>Dosja e programit të studimit përmban informacione të detajuara për studentët dhe detyrimet që ata kanë në programin e studimit. Gjithashtu studentët gjejnë modalitetet e pranimit dhe regjistrimit në Rregulloren e programit. Studentët njihen me kriteret e pranimit, regjistrimit, transferimit, ekuivalentimit, detyrimet përmyllyese etj. Të gjithë procedurat që UAL ndjek, merren në konsideratë dhe janë të</p>  |

|  |  |
|--|--|
| studimeve.   | harmonizuara në përputhje me aktet që ministria e arsimit nxjerr çdo vit akademik. Njëkohësisht merren në konsideratë edhe specifikat që ka institucioni apo kërkesat e programit të studimit. Ato janë të publikuara në faqen e internetit të ku studentët kanë akses në çdo kohë. Në përputhje me Statutin dhe Rregulloren e Universitetit, institucioni mund të vendosë kritere specifike në varësi të aplikimeve, specifikave dhe udhëzimeve nga ministria përgjegjëse për arsimin e lartë. <i>Takimi me stafin, sekretarinë., Ev 6.4 : Rregullore e programit të studimit.</i>  |
| <b>Kriteri 4.</b> Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit profesional në “Asistencë dentare” përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, ku përfshihen të gjitha Syllabuset e lëndëve sipas formatit zyrtar në të cilat paraqiten për secilën lëndë, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara, të firmosura nga titullari i Lëndës dhe përgjegjësi i Departamentit të Laborant Dentr. Syllabuset gjithashtu përmbajnë qëllimin, objektivat e Lëndës/modulit, ngarkesën, detyrimet e studentit në lidhje me frekuentimin dhe testimin si dhe vlerësimin përfundimtar të tyre. <i>Takimi me stafin, studentët.</i>  |
| <b>Kriteri 5.</b> Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.   | Programi i studimit është hartuar në vitin 2021 bazuar në eksperiencën e gjatë të vetë stafit të akademisë por edhe pas konsultimit me eksperiencat më të mira vendase dhe perendimore për ndërtimin e kurrikulave që mundësojnë formimin e asistentëve dentarë. Programi ofron për studentët njohuritë dhe kulturën e domosdoshme, të mjaftueshme dhe thellimin e dijeve. Ato zhvillohen duke marrë për bazë logjikën e ndërthurjes dhe të integritit të dijes e praktikës në auditore. UAL para fillimit të çdo viti akademik kujdeset që për programet e studimit që ofron, të rishikohen në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi. Kështu, është analizuar jo vetëm përshtatja e programeve të studimit sipas kuadrit ligjor por janë rishikuar gjithashtu në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm, në përputhje me nevojat e diktuar nga studimi i tregut të punës bazuar në zhvillimin ekonomik, demografik dhe teknologjik të vendit, të gjitha programet që UAL ofron. Proçedura e rishikimit të kurrikulës nis në nivel fakulteti pasi ai është përgjegjës për mbarëvajtjen e programeve dhe më pas grupi i rishikimit në bashkëpunim me NJSBC, analizon propozimet e departamenteve. Për aspekte të caktuara grupi kërkon asistencë teknike nga personeli akademik për përditësim në përmbajtje të programeve të studimit etj. Në të njëjtën kohë, janë rishikuar të gjitha syllabuset, sipas përcaktimeve të VKM Nr.41, shtojca 2, (e ndryshuar) duke mundësuar kështu rishikimin e syllabuseve në nivel Institucional. Ndryshime në programi nuk ka pasur pasi pritej diplomimi i brezit të parë me qëllim marrjen e një feedback-u nga Alumni pas përballjes me tregun e punës. Ndërkohë rishikimi i syllabuseve/ përditësimi i tyre, kryhet çdo fillim viti akademik. <i>Takimi me stafin.</i> |

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>Departamenti i Laborantëve Dentarë është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit, administrimin e veprimtarive akademike dhe koordinimin e brendshëm. Departamenti disponon dosjen e plotë të programit të studimit si dhe është përgjegjës për monitorimin e cilësisë së programit dhe përmirësimin të vazhdueshëm të saj. Përmbajtja e programit mësimor reflektohet në planin mësimor i cili paraqet një informacion të detajuar mbi numrin e lëndëve, moduleve, numrin e krediteve, orët në auditor dhe jashtë auditorit, tipet e veprimtarive të parashikuara dhe ngarkesën respektive të tyre, rishikimi i syllabuseve/përditësimi i tyre, kryhet në fillimin e vitit akademik.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

|  |   |
|--|---|
| <b>Standardi II.4</b>  |   |
| <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b> |   |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi</b>  |
| <b>Kriteri 1.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.   | Programi i studimit është me karakter profesional. Emërtimi është në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit janë ndërtuar në mënyre të tillë që të ofrojnë një bazë të gjerë njohurish në fushën e asistencës dentare dhe disiplinave si endodoncia, ortodoncia, kirurgjia dhe dentistria estetike, që t'ju mundësojnë studentëve punësimin në një shkallë të gjerë. Komponentet mësimore si mësimi në auditore (leksione, seminare, laboratore, praktika mësimore, webinarë online e trajnime me lektore të qendrave partnere, si dhe kontrolli i vazhdueshëm) janë në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogët e lëndës dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe praktik. Në veçanti lëndët karakterizuese të programit kanë në përmbajtje shumë orë laboratorit e praktike mësimore në laboratorët dhe klinikat e universitetit. Studentëve iu ofrohet mundësi punësimi, konform dhe pa çënuar programin mësimor, në klinika të ndryshme ku UAL ka kontakt ose bashkëpunon. <i>Takimi me stafin</i> |
| <b>Kriteri 2.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.   | Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve është organizuar duke respektuar ngarkesën që ka studenti gjatë një jave, semestri dhe viti akademik. Raportet e veprimtarive formuese janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të garantojnë kohën e nevojshme për studentët për të marrë njohuritë e nevojshme dhe aplikimin e tyre në praktikë. Shpërndarja e krediteve është bërë referuar udhëzimeve dhe rregullave, të vendosura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe aktet nënligjore në fuqi. <i>Takimi me stafin.</i>   |



|  |  |
|--|--|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> | <p>Natyra profesionale e programit të studimit kërkon raport të tillë midis teorisë dhe praktikës që mundëson aftësim profesional të studentëve. Në këtë kontekst programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/ aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Në përmbajtje të Lëndëve/ moduleve të programit i është dedikuar aftësimin në praktikë/ punë konkrete në profesion. Raporti teori/ praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Programi i studimit në hartimin e tij ka marrë në konsideratë balancimin midis aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike në raport të tillë që përmbushte kriteret e vendosura.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev 7: Tabela 9.</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>  | <p>Programi i studimit ofron njohuri, aftësim dhe kompetenca në asistimin e praktikave të ndryshme dentare, thellim në procedurat praktike të punës që lidheshin me asistimin, ndihmën në emergjencat dentare. Raporti teori/praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në këtë program studimi sikundër kemi përmendur, është fokusuar maksimalisht drejt praktikës profesionale. Kjo pasi edhe objektivat e programit synojnë të plotësojnë nevojat praktike të fushës të aftë të përdorin teknikat dentare, duke kombinuar njohuritë nga shkencat e materialeve dhe aplikimit të tyre. <i>Takimi me stafin</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.</p>  | <p>Çdo vit, bazuar në planet vjetore, Universiteti "Aldent" kryen procedurën për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Njësia bazë vlerëson periodikisht gjendjen e programeve të studimit, cilësinë, stafin akademik të rekrutuar, blerjet e aparaturave, instrumentave, materialeve në funksion të përmirësimit të mësimin e kërkimit, literaturën e re në bibliotekë, etj.</p> <p>Meqënëse programi është i ri, nuk janë aplikuar ndryshime në përmbajtje. Ndërsa për syllabuset e lëndëve, çdo fillim viti, departamenti kërkon që personeli të reflektojë praktika e zhvillime të fundit në fushën e dentistrisë dhe teknikave dentare si edhe të ndryshojë praktikën mësimore për të aftësuar sa më cilësisht studentët, duke qenë se kjo fushë ka zhvillime të shpejta të teknologjisë dhe përdorimit të saj. Këto ndryshime kanë ardhur nga nevoja për të përfshirë në program edhe njohuri të reja mbi përdorimin e teknikave dhe aparaturave të reja të blera rishtaz në UAL. Ndërsa ndryshime minore, janë bërë për sa i përket, rezultateve të të nxënësve, kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura dhe në fund vlerësimin përfundimtar nga pedagogu i Lëndës. <i>Takimi me stafin.</i></p> |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e</p>  | <p>Një nga pikat e forta e UAL është profili i institucionit drejt aplikimeve praktike dhe orientimit të studentëve me tregun e punës. Institucioni ka siguruar marrëveshje bashkëpunimi me shumë institucione të cilat kanë mundësuar jo vetëm kontributin në hartimin e kurrikulës dhe syllabuseve, praktikat profesionale, zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, etj. Kryerja e një volumi të madh praktikë dhe ndjekja e studentëve dhe vlerësimi i tyre në praktikë,</p>  |



|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| profesionit.  | garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit dhe siguron punësim të shpejtë të tyre pasi aftësitë profesionale që ata demostrojnë, përmbushin kërkesat që klinikat kanë. <i>Takimi me stafin</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. | Programi i studimit është organizuar në përmbajtje me qëllim arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e asistencës dentare. Këto njohuri mundësojnë punësimin e menjëhershëm të studentëve në klinika brenda dhe jashtë vendit.<br>Programi i studimit është projektuar me qëllim plotësimin e nevojave specifike aktuale të tregut të punës.<br><i>Takimi me stafin, studentët.</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Programi i studimit është me karakter profesional. Emërtimi është në përputhje me fushën dhe nivelin e studimit. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit janë ndërtuar në mënyre të tillë që të ofrojnë një bazë të gjerë njohurish në fushën e asistencës dentare dhe speciliteteve të stomatologjisë, që t'ju mundësojnë studentëve punësimin në një shkallë të gjerë. Një nga pikat e forta e UAL është profili i institucionit drejt aplikimeve praktike dhe orientimit të studentëve me tregun e punës. Programi i studimit është organizuar në përmbajtje me qëllim arsimimin profesional dhe kualifikimin shkencor të studentëve në fushën e asistencës dentare.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

### Standardi II.5

**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu e punës. | Universiteti "Aldent" ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh me të cilët ishin lidhur marrëveshje bashkëpunimi, kontrata dhe angazhime.<br>Programi është në përputhje të plotë me kërkesat e tregut për asistentë dentar. Mundësia për punësim është e madhe, në institucionet dhe klinikat me të cilat UAL ka bashkëpunime.<br>Studentëve u ofrohet mundësi punësimi edhe gjatë ciklit të studimeve, kjo si rrjedhojë e nevojave të tregut por gjithashtu dhe si rezultat i angazhimit nga stafi akademik për të mbështetur këta student në aftësimin e mëtejshëm praktik dhe orari mësimor i përshtatshëm.<br><i>Ev.5.1: Studim Tregu</i> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban   | Studentët në këtë program studimi të cilët punojnë si asistent që në vitet e shkollës janë të përfshirë vazhdimisht në diskutime në lidhje me programin e studimit. Modulet janë azhurnuar duke diskutuar raste  |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 19

|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>  | <p>konkrete pacientësh nga praktika klinike.</p> <p>Kjo eksperiencë është konsideruar pozitive dhe shikohet si një përmirësim në drejtim të organizimit të programit.</p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.</p> | <p>Programi akreditohet për herë të parë, ndryshimet që mund të bëhen në programin mësimor janë deri në masën 20% me propozim të senatit akademik. Institucioni ka të përcaktuar në strategjinë e vet, përmirësimin, përditësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet e dhëna nga partnerët, bashkëpuntorët, studentët e diplomuar dhe ekspertët e fushës së stomatologjisë. Gjithashtu merren në konsideratë dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme duke reflektuar kërkesat dhe nevojën që tregu ka. Ky proces është zhvilluar gjatë fazës së hartimit të programit në kuader të licensimit dhe do të ndiqet në fazën e përmirësimit të tij.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev12: Rregullore e kurrikulës</i></p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Universiteti "Aldent" ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh me të cilët janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi, kontrata dhe angazhime. Institucioni ka të përcaktuar në strategjinë e vet, përmirësimin, përditësimin e programit të studimit në përputhje me propozimet e dhëna nga partnerët, bashkëpuntorët, studentët e diplomuar dhe ekspertët e fushës së stomatologjisë.</i></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |   |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b></p> | <p>Nuk përmbushet</p> | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |                       |                              |                             | X                            |




### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| Standardi III.1   |  |
|---|--|
| Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.   |  |
| Kriteret  | Vlerësimi  |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p> | <p>Mësimdhënia në programin 2-vjeçar zhvillohet sipas syllabuseve të programit të studimit. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive sikundër janë parashikuar dhe në ligj të ndara në leksione, seminare, detyra/projekte, punë laboratorike dhe praktika mësimore e profesionale, të cilat realizohen në përputhje me planin mësimor. Raporti teori/praktike në orët e këtij programi profesional janë ruajtur në minimalen që lejon VKM në favor të praktikës meqenëse objektivat dhe misioni i programit lidhen më shumë me aftësimin praktik profesional të studentëve.</p> <p>Veçanërisht në lëndët karakterizuese, laboratorët dhe praktikat mësimore janë parashikuar me numër të madh orësh në laboratorët e mirëpajisur të Universitetit “Aldent”. Praktikant mësimore mund të kryhen edhe në bashkëpunim me klinikën dentare me pacientë realë të klinikës universitare. Lëndët bazë janë parashikuar të transmetojnë njohuri kryesisht përmes leksioneve, seminareve e detyrave të kursit. Çdo syllabus e ka të përcaktuar qartë formën dhe metodologjinë e mësimdhënies, i cili hartohet nga titullari i lëndës dhe respekton lirinë akademike. <i>Takimi me stafin</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>  | <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit, ka eksperiencë të gjatë në mësimdhënie. Kjo do të thotë se ata kanë aftësitë profesionale të kuptojnë nevojat që kanë studentët dhe të organizojnë veprimtaritë e tyre të procesit mësimor në funksion të përbushjes së këtyre nevojave.</p> <p>Metodologjia e mësimdhënies është përshtatur me natyrën e programit të studimit duke mundësuar forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kontrollit të dijeve të formateve të ndryshme. Këto forma parashikohen në planet mësimore, programet e moduleve, dhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Si një praktikë e mirë e mësimdhënies vihet re komunikimi ndërmjet pedagogut të lëndës dhe studentit nëpërmjet sistemit të platformës online të universitetit. Nëpërmjet platformës online, studenti ka akses në leksione, ushtrime dhe literaturë nga librari online, si dhe ka mundësinë të komunikojë vazhdimisht me pedagogun për detyra kurse, ushtrime pa qenë prezent në ambientet e universitetit.</p> <p>Gjatë mësimdhënies dhe praktikave laboratorike shfrytëzohet hapësira e klinikave për të zhvilluar praktikat mësimore.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev.19 : Trajnime stafi UAL</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e</p>   | <p>Pavarësisht nivelit të programit të studimit, personeli akademik dhe ndihmës-akademik i angazhuar në të, marrin pjesë rregullisht në aktivitete si simpoziume, leksione të hapura, workshope e konferenca,</p>  |

|   |  |
|---|--|
| <p>kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>   | <p>si brenda edhe jashtë vendit, ku kanë mundësinë të krijojnë eksperiencë të vlefshme për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. Në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies, të cilat mirëpritën nga studentët. Infrastruktura në dispozicion të personelit akademik lejon dhe mundëson përdorimin e teknologjisë dhe formave bashkëkohore të mësimdhënies. Ndërkohë përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie dhe i sistemit të menaxhimit që universiteti disponon, kanë mundësuar rritjen e aftësive didaktike të stafit akademik.</p> <p><i>Takimi me stafin</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik të student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> | <p>Personeli akademik i angazhuar në programin 2 vjeçar të studimit, plotëson kriteret ligjore të kualifikimit të përcaktuara në ligjin në fuqi. Rezultatet e anketimeve të realizuara nga NJSBC me studentët dhe konsultimet e realizuara në departament midis stafit akademik i shërbejnë personelit akademik të programit të studimit për të përmirësuar format e mësimdhënies duke përfshirë edhe mendimet e studentëve. Personeli akademik është gjithmonë i hapur drejt aplikimit të formave, mënyrave, metodave alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Prezantimi i rasteve konkrete me pacientë nga eksperiencë e dokumentuar e lektorëve gjatë leksioneve e seminareve nëpërmjet slideve dhe videoregjistrimeve i informon drejt studentët dhe i përfshin ata në diskutime me pedagogët mbi mënyrat e ndryshme të asistimit dhe sfidave të asistimit në poltron.</p> <p><i>Takimi me stafin, Zyrën e Burimeve njerëzore</i></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>  | <p>Në veprimtarinë e vet, departamenti dhe NJSBC janë të angazhuar të monitorojnë dhe vlerësojnë veprimtarinë akademike të personelit akademik. Nëpërmjet monitorimeve, komunikimeve të drejtpërdrejta, pyetësorëve etj, në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit, strategjinë për zhvillim të tij, si dhe në përputhje me nevojat e mësimdhënies, janë organizuar pyetësore me studentët e programit. UAL vlerëson në mënyrë periodike gjendjen e programit të studimit, cilësinë, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtarinë kërkimore shkencore. Përmirësimi të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe tërheqjes së mendimit të studentëve mbi këtë temë, i shërben edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila anketon studentët dhe personelin. Rezultatet e përpunuara të anketimeve diskutohen në mbledhjet e departamentit.</p> <p><i>Takimi me NJSBC, stafin, Ev. 21.3 Pyetësor i studentëve.</i></p>                          |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë</p>   | <p>Departamenti përmes kontrolleve të vazhdueshme, planit të aktiviteteve të personelit akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe me njësitë e tjera të Akademisë, sic ishin Senati, Bordi i Administrimit dhe NJSBC, angazhohen në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</p> <p>Nëpërmjet pajisjes së laboratorëve me aparatura të teknologjisë së</p>   |

*Republika*





|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p> | <p>fundit mbështetet edhe eksperimentimi në fushën e mësimdhënies. <i>Takimi me NJSBC, stafin, Ev. 20 :Print screen Platforma online ual.iqe.al</i></p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Mësimdhënia në programin 2 vjeçar zhvillohet sipas syllabuseve të programit të studimit. Raporti teori/praktike në orët e këtij programi profesional është ruajtur në minimalen që lejon VKM në favor të praktikës meqenëse objektivat dhe misioni i programit lidhen më shumë me aftësimin praktik profesional të studentëve. Personeli akademik i angazhuar në programin 2-vjeçar të studimit, plotëson kriteret ligjore të kualifikimit të përcaktuara nga ligji. Në veprimtarinë e vet, departamenti dhe NJSBC janë të angazhuar në monitorojnë dhe vlerësojnë veprimtarinë akademike të personelit akademik. Departamenti përmes kontrolleve të vazhdueshme, planit të aktiviteteve të personelit akademik dhe anketimeve të studentëve, në bashkëpunim edhe me njësië e tjera të universiteti, siç janë Senati, Bordi i Administrimit dhe NJSBC, angazhohen në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</i></p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |  |                              |                             | <p>X</p>                     |

|  |  |
|--|--|
| <p><b>Standardi III.2</b></p>  |  |
| <p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>  |  |
| <p><b>Kriteret</b></p> <p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p> | <p><b>Vlerësimi</b></p> <p>Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për studentët për detyrimet akademike që ata kanë gjatë zhvillimit të veprimtarive mësimore. Ky informacion u bëhet i ditur studentëve që në fillim të vitit akademik. Si rregullorja e programit, rregullorja e përgjithshme e Universitetit Aldent dhe informacione të tjera, janë publikuar në faqen e internetit të UAL (ual.edu.al). Studenti shlyen detyrimet akademike semestrale ose vjetore dhe vlerësohet me notë duke fituar në këtë mënyrë kreditet respektive.</p> <p><i>Takimi me NJSBC, stafin, Ev.6.3: Rregullore e departamentit, Ev.22: Rregullore e sekretarisë</i></p> |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 23



|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lënde/ moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/ modulit.</p>               | <p>Në fillim të vitit akademik titullari i secilës lëndë, në orën e parë, informon studentët mbi përmbajtjen e lëndës, temat që do zhvillohen, mënyrën e vlerësimit etj, duke i njohur kështu studentët me syllabusin e plotë. Krahas vlerësimit me testim në fund të procesit mësimor, studentët vlerësohen në lëndët e parashikuara me praktika mësimore e laborator, edhe nëpërmjet vlerësimit të protokolleve të punëve laboratorike apo projekt/detyrave të kursit që ata dorëzojnë. Kjo metodologji e vlerësimit iu bëhet e ditur studentëve në fillim të vitit nga titullari i lëndës. <i>Takimi me stafin, Ev 11 : Syllabuset e moduleve</i></p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.</p> | <p>Raportet mbi peshën e vlerësimit gjatë gjithë vitit dhe provimit përfundimtar janë të përcaktuara në syllabuset e Lëndëve. Për natyrën që ka programi i studimit, rëndësi i kushtohet aftësive profesionale të cilën studentët e demonstrojnë nëpërmjet asistimit në disiplina të ndryshme praktike nën mbikqyerjen e mjekut përgjigjës për praktikën. <i>Takimi me NJSBC, stafin</i></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Rregullorja e programit të studimit dhe syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm për studentët për detyrimet akademike që ata kanë gjatë zhvillimit të veprimtarive mësimore. Raportet mbi pjesën e vlerësimit gjatë gjithë vitit dhe provimit përfundimtar janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve. Krahas vlerësimit me testim në fund të procesit mësimor, studentët vlerësohen në lëndët e parashikuara me praktika mësimore e klinike, edhe nëpërmjet vlerësimit të protokolleve të projekteve/detyrave të kursit që ata dorëzojnë.</i></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>  | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |  |                              |                             | <p>X</p>                     |

**Standardi III.3**

**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p> | <p>Format dhe mënyrat e vlerësimit janë përcaktuar në syllabuset e lëndëve dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të programit mësimor. Format e vlerësimit teorik e praktik përfshijë seminare, detyra, projekte, pune laboratorike etj. Në përfundim të secilit modul është parashikuar zhvillimi i provimit përkatës. Një pjesë të rëndësishme të vlerësimit përfundimtar e zë përgatitja e studentit gjatë gjithë vitit, dorëzimi i punimeve, detyrave.<br/><i>Takimi me NJSBC, stafin</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në</p>  | <p>Programi i studimit në objektivat e veta kryesore ka përgatitjen e</p>   |




|   |  |
|---|--|
| <p>zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>   | <p>studentëve me njohuri dhe aftësi praktike. Në rastet e testimit të pjesës teorike me shkrim provimi realizohet duke respektuar sistemin e kodimit. Vlerësimi kryhet edhe mbi bazën e aftësive praktike profesionale që demonstron studenti. Për të shmangur rastet e vlerësimit subjektiv, gjithnjë vlerësimi i njohurive teorike apo praktike bëhet me komision vlerësimi. UAL ka investuar për krijimin një sistemi të brendshëm elektronik, i cili shërben si burim informacioni dhe komunikimi për studentët dhe stafin akademik. Studentët mund të logohen në këtë sistem nëpërmjet një adrese të institucionit, me të cilën pajisen në momentin e regjistrimit dhe aty mund të njihen me komunikimet dhe njoftimet e postuara nga sekretaria, pedagogu i lëndës apo nga strukturat drejtuese të UAL. Studentët kanë akses në rezultatet personale të provimeve ose testimeve.</p> <p><i>Takimi me stafin</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>  | <p>Raportet mbi vlerësimin përfundimtar të lëndëve/moduleve bëhen në përputhje me syllabuset e cdo lëndë dhe Rregulloren e programit, Rregulloren e përgjithshme të universitetit dhe natyrën e lëndës/modulit të zhvilluar.</p> <p><i>Takimi me NJSBC, stafin, studentët</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p> | <p>Në programin e studimit, studiojnë një numër i vogël studentesh çka mundëson komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtëpërdrejtë me studentët gjatë gjithë vitit. Kështu, gjatë kryerjes së praktikës, e cila zë një pjesë të rëndësishme të vlerësimit të studentëve, ata asistohen, u japin komente dhe sugjerime mbi punën e kryer në mënyrë që të përmirësohen vazhdimisht. Gjithashtu, personeli akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente/ feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/ prezantimit të detyrave/projekteve të kursit, dhe u jep këshilla/ orientime atyre se si mund të përmirësojnë performancën në të ardhmen. Studentët që kanë nevojë për përmirësim, ndiqen nga afër nga pedagogu i lëndës, i cili i jep këshilla se si mund të përmirësojnë aftësitë praktike apo këshilla mbi përmirësimin e procesit të të nxënimit.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>  | <p>Anetaret e komisionit të provimit mbikëqyrin gjatë gjithë kohës për zhvillimin korrekt të provimit, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit. Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm gjatë kryerjes së provimeve. Mjediset e testimit janë të pajisura me sisteme kamerash çka e bën më të lehtë jo vetëm monitorimin por edhe transparencën në raste kontestimesh nga studentët.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, Ev. 12.1 : Procedura e provimeve</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në</p>  | <p>Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale, bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren e provimeve. Shkalla e përvetësimit të programit mesimor vlerësohet me notë. Nota kaluese më e ulët është nota 5 pesë. Studenti ka të drejtë të njihet me rezultatet</p>   |




|   |  |                       |                      |                                   |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------------------|
| rregulloret përkatëse.  | e vlerësimit, si edhe komentet/ feedback të dhënë nga pedagogu/komisioni. Rezultatet e provimit u behen të njohura studentëve nga komisioni në përfundim të provimit me gojë dhe për provimet me shkrim, pas korrigjimit të tyre. Rezultatet e provimit hidhen në sistem dhe studenti i shikon.<br><i>Takimi me stafin, studentët</i>  |                       |                      |                                   |
| <b>Kriteri 7.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Pas shpalljes së rezultateve paraprake të provimit (hedhjes së tyre në sistem) studenti ka të drejtë të njihet me fletën e provimit pas korrigjimit pasi të bëhet edhe ç'sekretimi i tyre. Ai njihet me pikët totale të vlerësimit në fletë si dhe me pikët në çdo rubrikë.<br>Nëse studenti konstaton se ka rubrika te pakorrigjuara apo pikë të pallogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të reklamojë provimin në një kërkesë me shkrim, e cila depozitohet pranë sekretarisë, brenda 48 oreve nga shpallja e rezultateve. <i>Takimi me stafin, studentët.</i> |                       |                      |                                   |
| <b>Kriteri 8.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.           | Janë të pakta rastet ku studenti është drejtuar departamentit apo dekanatit për zgjidhjen e problematikës së vlerësimit pasi në shumicën e rasteve kur ka patur kontestim të vlerësimit, ato janë qartësuar nga komisioni i vlerësimit. Në rastet kur është e nevojshme, ngrihet një komision i posaçëm për të rikorrigjuar provimin. Proçesi i ankimit të rezultateve të provimeve shqyrtohet nga një komision i ngritur në përputhje me rregulloren e provimeve. <i>Takimi me stafin, studentët.</i>   |                       |                      |                                   |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Format e vlerësimit teorik e praktik përfshijnë seminare, detyra, projekte, pune laboratorike etj. Vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale, bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloren e programit. Studenti ka të drejtë të njihet me rezultatet e vlerësimit, si edhe komentet/feedback të dhënë nga pedagogu/komisioni. Rezultatet e provimit u behen të njohura studentëve nga komisioni pas korrigjimit të tyre me një afat 7 ditor nga dita e testimit.</i>  |                       |                      |                                   |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht<br><b>X</b> |

#### Standardi III.4

**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Edhe pse një program me karakter profesional, në çdo Lëndë/modul janë përcaktuar një numër orësh me qëllim formimin teorik të studentëve. Kurrikula e programit garanton marrjen e njohurive të nevojshme në mënyrë që studentët të jenë të aftë të zbatojnë ato në praktikën laboratorike. Ndërthurja e njohurive me praktikën janë në themel të parimeve kryesore që ka programi i studimit. Në këtë mënyrë studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e |



|   |  |
|---|--|
|   | të veçanta ne funksion të asistencës dentare. Kjo garantohet nëpërmjet zhvillimit të një miksimi të balancuar të lëndëve baze, me lëndët zgjedhore. <i>Takimi me stafin, studentët</i>   |
| <b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.   | Programi i studimit i përket fushës së shëndetësisë. Në këtë drejtim institucioni fokusohet që përveç aftësive profesionale, një student i diplomuar duhet të demonstrojë njohuri të gjithanshme, përfshirë ato të teknologjisë së informacionit, komunikimin e etikën profesionale të punës. Kjo ka rezultuar e suksesshme referuar rezultateve të punësimit të studentëve në programet e tjera të studimit.<br><br><i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.   | Në syllabuset e çdo lëndë studentët gjejnë informacion në lidhje me kompetencat dhe aftësitë që marrin në modulin përkatës. Në javën e fundit të semestrit, pedagogoet e moduleve realizojnë një përmbledhje dhe rishikim të kompetencave dhe aftësive që synohen të arrihen nga ana e studentëve në përfundim të modulit.<br>Njëkohësisht, merret edhe feedback nga ana e studentëve lidhur me objektivat e vendosura për këtë qëllim. Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me mbledhjen e krediteve dhe mbylljen e detyrimeve akademike.<br><br><i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 4.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Infrastruktura në UAL është një nga më të avancuarat në fushën e stomatologjisë në vend. Kjo tregon interesin dhe fokusin që ka institucioni për të ofruar mundësi të aplikimit të njohurive teorike në praktike për çdo lëndë e modul. Për module të caktuara të kurrikulës, studentët testohen t'i aplikojnë këto kompetenca në klinikat ku zhvillohet praktika, sic janë klinikat e protetikës, kirurgjisë, terapisë, periodontologjisë dhe ortodoncisë. Pas kësaj vihen të punojnë në grupe prej tre apo katër studentësh ose pune individuale, punë e cila materializohet në një detyrë apo projekt kursi ku qëllimi është testimi i kompetencave të fituara. Personeli akademik në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienton dhe instrukturon grupin e studentëve në realizimin e detyrës së caktuar. Në këtë proces, personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në punimet praktike dhe zgjidhjet e duhura të problematikave dhe identifikon specifikat dhe momentet që kanë nevojë për më tepër informacion dhe studim të mëtejshëm. Këto probleme pastaj bëhen objekt i kërkimeve të mëtejshme duke u materializuar në detyra kursi etj.<br><br><i>Takimi me stafin, studentët.</i> |
| <b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.  | Personeli akademik integron të reja më të fundit të shkencës dhe teknologjisë në informacionin që ju jepeshin studentëve gjate orarit normal të zhvillimit të modulit. Përsa i përket personelit të ftuar, fakulteti vit pas viti fton pedagoge nga universitetet partnere në kuader të projekteve apo konferencave të ndryshme që zhvillohen, të cilët japin leksione me studentët për përmbajtjen e të cilave bihet dakort paraprakisht me departamentin. Synohet që përmbajtja e leksioneve jashtë programit të studimit të përfshinte të reja me të fundit të  |




|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | shkencës.<br><i>Takimi me stafin, studentët, Ev.19 : Trajnime stafi UAL</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <i>Edhe pse nje program me karakter profesional, ne çdo lëndë/modul janë percaktuar një numër orësh me qëllim formimin teorik të studentëve. Kurrikula e programit garanton marrjen e njohurive të nevojshme në mënyrë që studentët të jenë të aftë të zbatojnë ato në praktikën klinike. Ndërthurja e njohurive me praktiken janë në themel të parimeve kryesore që ks programi i studimit. Në këtë mënyrë studenti thellon njohuritë dhe zhvillon aftësitë profesionale e të veçanta në funksion të asistencës dentare. UAL me anë të trajnimeve të ndryshme dhe rekrutimit të personelit akademik të kualifikuar dhe me specialitë të fushës u jep mundësi studentëve të marrin forma të ndërthurura të mësimdhënies.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

### Standardi III.5

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.**

| Kriteret   | Vlerësimi  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.   | UAL informon studentët mbi mbledhjen e krediteve për tu diplomuar bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit. Në programin me karakter profesional, diploma jepet kur studenti ka shlyer të gjitha detyrimet e tjera akademike.<br><i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.   | Institucioni nëpërmjet pedagogëve udhëheqës ndjek nga afër praktikat, projektet/ detyrat. Gjithashtu gjatë semestrit të fundit, pedagogët e lëndëve, organizojnë herë pas here takime me studentët për t'i udhëzuar për detyrimet përmbyllëse.<br>Studenti ka informacionet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi dhe realizimin e tij.<br><i>Takimi me stafin, studentët</i> |
| <b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Programi profesional 2-vjecar në Asistencë dentare nuk parashikon një provim final por merren për bazë të gjithë provimet e dhëna në 2 vitet e shkollës.   |
| <b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon  | Në vlerësimin përfundimtar komisioni merr në konsideratë arritjet e studentit në dy vitet e para, pra mesataren e ponderuar.   |



|  |  |
|--|--|
| <p>studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>        |  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.</p>   | <p>Infrastruktura laboratorike dhe klinike e institucionit është e mjaftueshme, e mirëpajisur dhe mbulon nevojat që programi i studimit ka dhe i mirëpret duke u vënë në funksion të ambicieve shkencore të studenteve.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studentit vlerësohet me notë.</p>   | <p>Organizimi i provimeve bëhet në përputhje me syllabuset e çdo lënde dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore, Rregulloren e përgjithshme të Universitetit dhe rregulloren e programit të studimeve. Studenti shlyen detyrimet akademike vjetore dhe vlerësohet me notë duke fituar në këtë mënyrë kreditet respektive. Studenti vlerësohet me notë mesatare të ponderuar që përfshin provimet e dhëna gjatë gjithë viteve.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p> | <p>Në përfundimin me sukses të ciklit të studimit studentit pajiset me diplomë universitare dhe listë me nota të cilësuar me ciklin dhe emërtimin e diplomës së marrë, kjo e fundit sipas gjithë udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi.</p> <p>Gjithashtu në dispozicion të studentëve vihet edhe programi i plotë mësimor i nënshkruar nga Rektori për ciklin përkatës të studimit.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>   | <p>Sekretaria mësimore mban regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e leshimit të diplomave etj, të formatuara këto sipas akteve nënligjore në fuqi. Gjithashtu sekretaria mësimore arkivon edhe dokumentacionin e plotë të studentëve të diplomuar sic janë listat e notave, dokumentacionin e aplikimit etj. Regjistrat e studentëve plotësohen në formë të shkruar dhe elektronike dhe mbahen në ruajtje të përhershme. Çdo student, me regjistrimin fillestar në Universitet, pajiset me numër unik matrikullimi nga Qendra e Shërbimeve Arsimore që e shoqëron deri në marrjen e</p> |

*Popudhe*

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | diplomës.   |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>                         | <p><i>Universiteti Aldent informon studentët mbi procedurat e marrjes së diplomës me provim përfundimtar bazuar në përcaktimet e rregulloreve përkatëse të programeve të studimit. Institucioni nëpërmjet pedagogëve udheheqës ndjek nga afër praktikat, projektet/detyrat. Studenti shlyen detyrimet akademike vjetore dhe vlerësohe me notë duke fituar në këtë menyre kreditet respektive. Në vlerësimin përfundimtar komisioni merr në konsideratë arritjet e studentit në dy vitet e para, pra mesataren e ponderuar.</i></p> <p><i>Sekretaria mësimore mban regjistrat bazë të studentëve me të dhëna personale të tyre, regjistrin me vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit, si dhe regjistrin e lëshimit të diplomave e marrë bashkë me listën e notave.</i></p> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |   |                              |                             | X                            |

### Standardi III.6

**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

| Kriteret   | Vlerësimi  |
|--|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Mjediset ku zhvillohet veprimtaria akademike si klasat, laboratorët, janë pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, ambiente për laboratorë të degëve të ndryshme, ambiente për bibliotekën, senatin, salla audiovizive, salla kompjuteresh, salla për konferenca, çka mundësojnë aplikimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe praktikës profesionale etj. Personeli gëzon lirinë akademike për të vënë në zbatim shembuj, ide të reja e inovative të mësimdhënies, duke sjellë eksperiencë të ndryshme. Për përdorimin e gjithë infrastrukturës fizike apo digjitale, stafi ëshët i trajnuar dhe ka në dispozicion manuale përdorimi dhe shembuj praktikash të mira të përdorimit të tyre. <i>Takimi me stafin, studentët</i>   |
| <b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.            | Për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe pikave të tjera kritike të cilësisë mësimore, UAL dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) hartojnë kontrolle dhe anketime me studentë dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie. Në mënyrë për të verifikuar dhe kontrolluar cilësinë, UAL ka lidhur marrëveshje me IQE për të zhvilluar kontrolle të jashtme. IQE zhvillon në mënyrë të vazhdueshme anketime dhe pyetësorë me studentë. Në fund të procesit, IQE ofron analizën mbi pikat e forta dhe ato kritike të cilat mund të përmiresohen. Të dhënat e marra përgjate semestrit, i jepen departamenteve përkatëse, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe përshtatjes së nevojave të ndryshme përgjatë viteve të studentëve. <i>Takimi me stafin, studentët , Ev. 21.1.1 Raport NJSBC,</i> |

|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>22.4.1 Formular performance</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 3.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.  | Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan koordinatori i programit të studimit i cili jo vetëm koordinon punën e personelit akademik por njëkohësisht mban kontakte të vazhdueshme edhe me studentët. Rezultatet e anketave dhe pyetesorëve, bëhen publike në format të dhënash për studentët në stendat informuese dhe në mënyrë digjitale. Analiza e gjerë ndahet me departamentet dhe dekanatin, në të cilin diskutohet në mënyrë konstruktive për problemet dhe pikat e forta. <i>Takimi me studentët, Ev. 21.3 Pyetësor i studentëve</i>        |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Këto praktika vlerësimi kanë shërbyer për të konsoliduar mekanizmat e brendshme të cilësisë. NJSBC ka marrë rol kryesor promovues në përmirësimin dhe zhvillimin e cilësisë së mësimdhënies. Si një strukturë e mirëorganizuar stafi akademik, praktikat e mira, gjejnë mbështetje të shpejtë dhe adaptohen gjithashtu në mënyrë të shpejtë. Ndërkohë për praktikat e mira të evidentuara nga studentët apo me mekanizmat e tjerë të vlerësimit të NJSBC, personeli akademik promovohet dhe mbështetet vazhdimisht. <i>Takimi me stafin, studentët</i> |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Infrastruktura aktuale që universiteti disponon mbështet aplikimin e të gjithë elementëve të nevojshëm mësimore, praktikës profesionale etj. Për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe pikave të tjera kritike të cilësisë mësimore, UAL dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) hartojnë kontrolle dhe anketime me studente dhe stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie. Rezultatet e anketave dhe pyetesorëve, bëhen publike në format të dhënash për studentët në stendat informuese dhe në mënyrë digjitale.</i>          |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

|   |                       |                              |                             |                              |
|---|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |                       |                              |                             | X                            |

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA  
PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

| <b>Standardi IV.1</b>  |  |
|--|--|
| <b>Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</b>  |  |
| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi</b>   |
| <p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p> | <p>Ky program studimi përfaqëson një fushë studimore në të cilën Universiteti Aldent ka një eksperiencë të gjatë që prej themelimit të saj në vitin 2003. Staf i akademik efektiv, ai me kontrate dhe personeli ndihmës akademik kanë formimin e duhur teorik dhe praktik dhe janë interdisiplinar duke dhënë një mbiveshtrim të nevojshëm të fushës së studimit. Staf i akademik dhe ndihmës akademik i këtij programi, ofron kualifikimin e duhur për përmbushjen me sukses të moduleve të percaktuara dhe përmbush kriteret ligjore, pritshmeritë e studentëve për formimin e tyre të plotë konform kërkesave në treg.</p> <p>Për vitin akademik 2022- 2023 në këtë program janë angazhaur 11 staf efektiv (1 Prof As, 2 Dr, 5 Msc dhe 3 SPA) dhe 5 staf me kontratë (5 Msc).</p> <p>Personeli akademik dhe ndihmës akademik përditesojne njohuritë në mënyrë të vazhdueshme duke azhornuar studentët me të rejat e fundit të fushës. Gjithashtu ato kanë akses në trajnimet online, webinarë, literaturë dhe materiale të tjera interaktive të vëna në dispozicion online. <i>Takimi me stafin, Ev. 22.2 :Cv-të stafi akademik</i></p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>   | <p>Sipas kornizave ligjore personeli akademik efektiv mbulon mbi 80% te ngarkesës mësimore totale. Institucioni ka rekrutuar personel akademik me kohë të plotë të cilët mbulojnë shumicën e lëndëve të programeve të studimit që institucioni ofron.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev 7: Tabela 4.</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>  | <p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit perbëhet prej profesionistesh me eksperiencë shume vjeçare në e fushën e stomatologjisë. Në këtë program studimi janë të angazhuar në mësimdhënie 16 pedagog, nga të cilët 5 prej tyre janë me kontratë. Personeli akademik efektiv është pjesë përbërëse e të tre njësive bazë të Fakultetit të Shkencave Dentare (FSHD).</p> <p>Stafi akademik i përzgjedhur vlerësohet për seriozitet, integritet, profesionalizëm, përkushtim dhe rezultate të matshme cilësore në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Sipas detyrimeve ligjore, stafi ka kontratë të rregullt pune me UAL. Universiteti nga ana e tij, kryen të gjitha detyrimet financiare në mënyrë të rregullt dhe transparente. <i>Takimi me stafin, Ev.7: Tabelat, Ev 22.3 : Kontrata e punës tip PAE, PAK</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe</p>  | <p>Në përputhje me nevojat për personel akademik, ndihmës apo personel administrativ që kishte çdo strukture brenda UAL, ndiqet një</p>  |

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Page 32






|  |  |
|--|--|
| <p>vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>  | <p>procedurë e qartë rekrutimi në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Fakultetit. Çdo shpallje për pozicion vakant publikohet në faqen zyrtare të internetit shoqëruar nga kriteret që kandidatët duhet të plotësojnë, dokumentacioni që duhet dorëzuar, periudha e ankimit dhe afatet për dorëzimin e dokumentacionit pranë UAL. Çdo kërkesë që lidhet me punësimin e personelit akademik, nis nga Njësia baze dhe sipas pozicionit/funksionit përcaktohen kriteret që duhet të përmbushë kandidati si parakusht për t'u pranuar si dhe kriteret që ai duhet të plotësojë në perspektive. Në çdo rast, rekrutimi i personelit akademik bëhet në përmbushje të kriterëve ligjorë përse i përket titujve akademike, statusit dhe ngarkesës mësimore që duhet të përmbushet sipas gradës shkencore. Përzgjedhja bëhet nga një komision <i>ad hoc</i> me një procedurë transparente për të gjithë. Komisioni vlerëson dosjet e paraqitura apo diskuton në mënyrë të drejtpërdrejtë për të gjykuar mbi aftësitë profesionale, kualifikimet themelore sipas kriterëve, kualifikimet shtesë dhe vizionin e perspektivës. Për personelin administrativ vendi vakant dhe kriteret përcaktohen nga administratori i UAL. Në punësimin e personelit ndihmës-akademik me karakter mësimor dhe ndihmës-akademik me karakter administrativ, UAL zbaton kriteret ligjorë në funksion të kërkesave të legjislacionit në fuqi. Punësimi i personelit në UAL respekton edhe kërkesat e Kodit të Punës ku çdo i punësuar rregullon marrëdhëniet e tij me një kontratë pune individuale.</p> <p><i>Takimi me stafin, ZBNJ, Ev 22.4 : Procedura e rekrutimit</i></p> |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>  | <p>Universiteti "Aldent" ka një qëndrueshmëri të vazhdueshme të personelit akademik të angazhuar jo vetëm në këtë program studimi i cili ka dy vite që ishte hapur por për të gjithë periudhën e funksionimit të tij si institucion i arsimit të lartë. Cdo pjestar i stafit akademik firmos një kontratë punësimi dhe nga ai moment ai mbulohet me sigurime shoqërore dhe shëndetësore nga institucioni sipas ligjeve në fuqi.</p> <p><i>Takimi me stafin, Ev15.1 Përshkrimi i laboratorëve, 15.2 Relacion infrastrukture</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe</p> | <p>Institucioni përditëson çdo vit akademik organigramën dhe ruan dhe shpërndarjen e detyrave në secilin prej pjestarëve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>Stafi akademik dhe ai ndihmës akademik përcaktohen nëpërmjet shpërndarjes së lëndëve përgjate semestrave. Të dhëna këto që grupohen së bashku me aktivitetet e tjera akademike si publikime, pjesëmarrje në konferenca apo seminare dhe aktivitete të tjera.</p> <p>Studentëve të programeve pranë UAL u prezantohet i gjithë stafi administrativ dhe rolet që ato mbulojnë, me gjithë mënyrat e çdo kontaktit me ta. Statistika të plota për personelin akademik mban Departamenti i Laborantëve Dentarë, ndërsa dosjet e stafit administrohen nga Zyra e Burimeve njerëzore e cila përditëson vazhdimisht dosjet e tyre. <i>Takimi me stafin, ZBNJ</i></p>   |

| administrativ.   |   |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
|--|---|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <b>Kriteri 7.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | <p>Ky program studimi ka një karakter praktik dhe i pajis studentët me njohuri praktike të asistencës dentare. Nëpërmjet bashkëpunimit me klinika të ndryshme dentare në Shqipëri studentëve u mundësohet mundësi aftësimi praktik të mëtjshëm. Me anë të konferencave dhe trajnimeve të kompanive prodhuese që UAL ka marrëveshje, u mundëson studentëve përditësimet më të fundit të teknologjisë nga kompanitë zhvilluese dhe praktike reale pune.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>  |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <b>Kriter 8.</b> Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.  | <p>Praktika, në mbështetje të synimit të këtij programi studimi me karakter profesional, zhvillohet në mënyre të vazhdueshme dhe me të njëjtat kushte si në klinikat dentare me moderne.</p> <p>Praktikat zhvillohen në klinikat e disiplinave të ndryshme të universitetit sipas syllabusit të lëndës "Praktikë profesionale" që informon studentin mbi kryerjen e praktikës. Në përfundim të çdo jave praktike hartohet një dëshmi e performancës studentit. Këto dëshmi janë edhe bazë e vlerësimit të studentit në këtë lëndë.</p> <p>UAL disponon infrastrukturë moderne laboratorike dhe klinike e cila mundëson jo vetëm kryerjen e praktikës profesionale por edhe kryerjen e punimeve në kuadër të aktivitetit shkencor të stafit e studentëve që angazhoheshin. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>  |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <b>Konkluzione</b>   | <p><i>Ky program studimi përfaqëson një fushë studimore në të cilën Universiteti Aldent ka një eksperiencë të gjatë që prej themelimit të tij në vitin 2003. Staf i akademik efektiv, ai me kontratë dhe personeli ndihmës akademik kanë formimin e duhur teorik dhe praktik, dhe janë interdisiplinar duke dhënë një kontribut të nevojshëm në këtë fushë studimit. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përbëhet prej profesionistesh me eksperiencë shume vjeçare në fushën e stomatologjisë dhe disiplina të tjera që ofrohen gjatë programit. Institucioni përditëson çdo vit akademik organigramën dhe ruan shpërndarjen e detyrave në secilin prej pjesëtarëve të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Praktika profesionale, në mbështetje të realizimit të këtij programi studimi me karakter profesional, zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me të njëjtat kushte si në klinikat me moderne të fushës.</i></p> |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>  | Nuk përmbushet       | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  |  | X |
| Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht   | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |  |   |
|  |   |                      | X                     |                      |                       |  |  |  |   |




**Standardi IV.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>  | <p>Universiteti “Aldent” ka në total në dispozicion 4 godina ku zhvillohet procesi mësimor me një sipërfaqe rreth 8500 m<sup>2</sup> dhe rreth 2500 m<sup>2</sup> ambiente parkimi dhe interaktiviteti. Mjediset mësimore janë të madhësive të ndryshme në përshtatje me natyrën e procesit mësimor që zhvillohet në to. Në këtë sipërfaqe kanë salla laboratorësh, salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet nga 30 deri në 120 studentë. Aktualisht kampusi i ri universitar është nga më modernët në vend me ambiente të dedikuara për një proces akademik me standarte të larta logjistike. Me hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, praktike e laboratorike.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët , Ev.15.2: Relacion infrastrukture</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>                    | <p>UAL ushtron veprimtarine e tij në 4 objekte të ndërtuara sipas një standarti të lartë me materiale mësimore cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarine mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën dhe plotëson teresisht nevojat higjieno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmerisë. Në aspektin teknologjik, mjediset ku zhvillohet mësimi për këtë program studimi, është i kompletuar në nivel aparatash dhe rrjeti kompjuterik. Sallat ku studentët zhvillojnë orët mësimore janë të pajisura me sistem projektimi, videoregjistrimi dhe demonstrimi të punimeve në kohë reale, ambientet janë të mbuluara me WiFi. Lidhjet në rrjet cilësohen të sigurta për përdoruesit dhe të dhënat e tyre. Shërbimet informatike si posta elektronike, magazinimi i të dhënave, klasat virtuale apo dhe shërbime të tjera, ofrohen nëpërmjet platformës online ual.edu.al.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët, Ev.6.6: Rregullore e sigurisë në laborator</i></p> |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> | <p>Për zhvillimin e orëve mësimore dhe atyre klinike, studentët kanë në dispozicion të gjitha paisjet e nevojshme për të kryer çdo proces. Paisjet dhe aparatet në dispozicion janë blerë të reja, në vitet e fundit dhe përfaqësojnë modelet me profesionale dhe moderne të mundshme për secilën teknike që përmendej në programin mësimor. Në sallat mësimore, ofrohen kushte projektimi, regjistrimi dhe prezantimi multimedial.</p> <p><i>Takimi me stafin, studentët</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,</p>  | <p>UAL vë në dispozicion të studentëve hapësira laboratorike, për të plotësuar të gjithë nevojat e programit të studimit. Studentët e UAL kanë të mundur të aksesojnë bibliotekën e cila disponon gjithë</p>  |




|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | literaturën më bashkohore sot, dhe sallën e informatikës e përbëre nga shumë njësi kompjuterike. Kjo u vlen studentëve të asistencës dentare të marrin njohuri baze në informatikë, gjithashtu formim në programet kompjuterike të vëna në shërbim të stomatologjisë, si kartela digjtale etj. Ky ambient si të gjithë ambientet e tjera ka akses në lidhje internet me kabëll apo WiFi të sigurt dhe me shpejtësi të lartë.<br><i>Takimi me stafin, studentët</i>   |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Universiteti "Aldent" ushtron veprimtarinë e tij në 4 objekte të ndërtuara dhe pajisura me materiale cilësore bashkëkohore, të shfrytëzueshme tërësisht vetëm për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore, si dhe administratën dhe plotëson tërësisht nevojat higjieno-sanitare duke shmangur elementet e rrezikshmërisë. Për zhvillimin e orëve mësimore dhe laboratorike, studentët kanë në dispozicion të gjitha paisjet e nevojshme për të kryer çdo proces. UAL vë në dispozicion të studentëve hapësira laboratorike e klinike, për të plotësuar të gjithë nevojat e programit të studimit. Studentët e UAL kanë të mundur të aksesojnë bibliotekën dhe sallën e informatikës për të vazhduar përgatitjen e tyre në formë autodidakte.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>   | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

### Standardi IV.3

**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjtale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj.<br><br>Për bibliotekën dhe teknologjinë janë vënë në dispozicion dy salla me kapacitet rreth 75 poste leximi, 25 poste interneti të pajisura me kompjuter dhe biblioteka që kanë rreth 15000 tituj librash profesionalë (biblioteka). UAL është i abonuar prej disa vitesh në bibliotekën "Hinari", bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët.<br><br><i>Takimi me stafin, studentët, Ev.23 :Biblioteka dhe menaxhimi i saj</i> |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.  | Biblioteka e institucionit disponon një numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë apo pas procesit mësimor. Orari i shërbimit është në përshtatje me orarin mësimor dhe nevojave të studentëve.<br><br><i>Takimi me stafin, studentët, punonjësi bibliotekës</i>   |



|  |   |
|--|---|
| <p><b>Kriteri 3.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>  | <p>Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore në gjuhën shqipe dhe të huaj. UAL ka në dispozicion të studentëve rreth 20 mijë tituj në një bibliotekë madhështore të hapur tashmë në kampusin e ri. Titujt në bibliotekë janë klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave dhe informatizimi i saj është i pasuruar me informacion të gjerë mbi materialin në brendësi të librit. Gjithashtu në bibliotekë depozitohen edhe tekstet e temave të diplomave që realizohen nga studentët e ciklit të dytë të studimit.<br/><i>Takimi me stafin, studentët.</i></p>   |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>  | <p>UAL është e abonuar prej disa vitesh në bibliotekën “Hinari”, bibliotekë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë e cila shfrytëzohet nga stafi dhe studentët nëpërmjet kompjuterave të instaluar në ambientet e bibliotekës dhe lidhur pa kufizim në internet dhe kohë. Shërbimi i bibliotekës ofrohet falas për çdo student apo staf akademik të univesirsitetit. <i>Takimi me studentët, Ev.7, Tabela 17</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.</p>   | <p>UAL investon vazhdimisht në përmirësimin e infrastruktures, rritjen e kapaciteteve të informatizimit, përmirësimin e mjediseve të punës si dhe ofrimin të faciliteteve për stafin dhe studentët. Njëkohësisht biblioteka është e pajisur me literaturë cilësore, gjithashtu ofron libraritë online të abonuara nga UAL dhe sallën e informatikës me softwarët e nevojshëm për studentët dhe pedagoget në fushën e dentistrisë. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me orarët e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>  | <p>Orari i bibliotekës dhe sallës së kompjuterave është ai zyrtar dhe i vënë plotësisht në shërbim të kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Në periudha të veçanta të vitit akademik, biblioteka është në dispozicion të studentëve në orare të zgjatura, ku nëse aksesohet jashtë orareve zyrtare të funksionimit të saj, caktohet një student përgjegjës i cili menaxhon funksionimin e bibliotekës gjatë këtij orari. Ndersa aksesimi në libraritë online është pa limit gjatë gjithë vitit akademik. <i>Takimi me stafin, studentët</i></p>  |
| <p><b>Kriteri 7.</b> Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet</p> | <p>Biblioteka menaxhohet nga një person përgjegjës, e cila është me një eksperiencë shumë vjecare në fushën e bibliotekës. Personi përgjegjës bën raportimin në mënyrë të vazhdueshme me njësitë përgjegjëse lidhur me përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimin e sallave të studimit. Kërkesa për titujt e rinj dërgohen në departament që të merren në konsideratë kur të bëhet lista e titujve të rinj për blerjen e radhës. Biblioteka është e pajisur me një sistem kompjuterik të menaxhimit ku personi përgjegjës është i trajnuar për përdorimin e tij në mënyrë sa më efektive duke lehtësuar punën në gjetjen e titujve.<br/><i>Takimi me stafin, studentët</i></p> |

| për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj. |  |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
|--|--|----------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|--|--|--|---|
| <b>Konkluzione</b>   | <i>Institucioni ka investuar në labororet e informatikës dhe në sallën e bibliotekës duke u ofruar studentëve burime të rëndësishme informacioni, dhe azhurnimi me literaturat më në zë. Sallat e informatikës janë të pajisura me softvare të përdorur në fushën e stomatologjisë. Të gjitha këto të vëna në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik. UAL konsideron si prioritet zhvillimin dhe pasurimin e fondit të bibliotekës me botimet e reja.</i> |                      |                       |                      |                       |  |  |  |   |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>                                 | <table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>   | Nuk përmbushet       | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |  |  |  | X |
| Nuk përmbushet   | Përmbushet pjesërisht  | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |                      |                       |  |  |  |   |
|  |  |                      | X                     |                      |                       |  |  |  |   |

|   |  |
|---|--|
| <b>Standardi IV.4</b>   |  |
| <b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.</b> |  |
| <b>Kriteret</b>   | <b>Vlerësimi</b>   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.                     | Gjatë vizitës në insitucion dhe duke naviguar faqen zyrtare të institucion konstatuam se përveç platformës së UAL e-Learning në Moodle, institucioni disponon sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave të studentëve. Që nga momenti i regjistrimit të dhënat pasqyrohen në sistemin FxEducation të UAL nga sekretaria mësimore ku edhe pasqyrohet aktiviteti i studentit gjatë gjithë kohës së studimit.<br><i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.          | Në sistemin e brendshëm FxEducation gjithashtu hidhen të dhënat e të gjithë stafit të angazhuar në varësi të njësisë kryesore, bazë dhe statusit të punësimit (Burimet njerëzore).<br>Të dhënat në sistemin Fx kanë akses të kufizuar në varësi të kompetencave dhe pozicionit të punës. Studentët e UAL informohen për gjithçka nëpërmjet platformës elektronike FxEducation që është një sistem i brendshëm menaxhimi të dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike dhe jo vetëm. Në këtë sistem ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit "Aldent" në rubrikën "portal i studentit" në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike e lidhur në internet. Gjithashtu në këtë platformë studentët regjistrohen online për provime në sesionet jo të rregullta të provimeve (vjeshtë, mbartje etj.)<br>Kordinatorët e programeve kanë gjithashtu akses të dedikuar vetëm në programin që koordinojnë në bazë të afateve të caktuara në sistem për kontrollin ose përditësimin e të dhënave të kërkuara. |

|  |   |
|--|---|
|  | <i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.   | Në sistem, nëpërmjet një portali të posaçëm, studentët informohen jo vetëm me njoftimet për procesin mësimor por edhe për veprimtari të tjera apo informacione të nevojshme që lidhen me kërkimin shkencor, aktivitetet studentore, mobilitetet etj. Të dhënat në lidhje me veprimtaritë, leksionet, detyrat dhe materiale të tjera, personeli akademik dhe studentët mund të kryejnë nëpërmjet UAL eLearning. UAL aplikon komunikimin e brendshëm institucional, përmes adresës elektronike që çdo aktor i institucionit disponon, përfshirë këtu të gjithë anëtarët e stafit akademik dhe administrativ (emër.mbiemër@ual.edu.al) dhe studentët (emër.mbiemër@student.ual.edu.al)<br><br><i>Takimi me stafin, studentët, Ev.12.3 FxEducation, Ev 12.4 : Portali i studentit</i> |
| <b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.                        | UAL e-Learnig është një sistem është ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuenton.<br>Zyra e IT mirëmban, ndjek dhe raporton në kohë reale për titullarët e institucionit duke gjeneruar raporte të ndryshme statistikore. Sistemi ka ndërfaqe shqip dhe anglisht dhe është i aksesueshëm edhe në versionin mobile.<br>Ndërkohë, FxEducation është një programi i sekretarisë mësimore ku mund të hyjë sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët. Secili grup ka hapësirën e vet të aksesit ku mund të logohet me të dhënat personale dhe mund të marrë informacionin për të cilin ka akses.  |
| <b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | <i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.           | Faqja zyrtare e UAL është aktive në dy gjuhë; shqip dhe anglisht. Studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit. Gjithashtu faqja e Universitetit është e lidhur edhe me platformën e-Learning dhe portalin e studentit ku studentët hyjnë me adresat dhe kodet e tyre individuale dhe marrin informacion për modulet.<br><i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Konkluzione</b>   | <i>UAL disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional e vë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik e administrativ për programin e studimit. UAL eLearnig është një sistem është ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuenton. Ndërkohë, FxEducation është një programi i sekretarisë mësimore ku mund të hyjë sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët. Secili grup ka hapësirën e vet të aksesit ku mund të logohet me të</i>  |





|  |  |                              |                             |                              |
|--|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
|  | <i>dhënat personale dhe mund të marrë informacionin për të cilin ka akses.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b> | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |  |                              |                             | X                            |

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.**

| Kriteret   | Vlerësimi   |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.  | <p>Në RVB citohet se që në momentin e planifikimit të çeljes së programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p>Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, kostot e auditeve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UAL.</p> |
| <b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | <p>Në përfundim të vitit kalendarik hartohen pasqyrat financiare të cilat tregojnë gjendjen e biznesit dhe masën e realizimit të Projekt-Buxhetit të përcaktuar.</p> <p>Në përfundim të përpilimit të pasqyrave financiare bëhet auditimi i përvitshëm i tyre. Në Shqipëri një universitet jo publik trajtohet si çdo biznes tjetër me gjithë të drejtat dhe detyrimet ndaj punonjësve, studentëve dhe ndaj shtetit. Duke qenë të tillë ai çdo vit harton pasqyrat financiare si Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci Kontabël), Pasqyra e performancës (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve), Pasqyra e Fluksit të mjeteve monetare dhe Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit Neto.</p>                                      |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.   | <p>Nga raportet financiare të UAL dëshmohet se, institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve individë, organizata, banka apo organe tatimore. Rritja ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UAL, duke qenë një garanci për të ardhmen.</p>   |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e   | <p>Pavarësisht vështirësive të evidentuara gjatë pandemisë, treguesit makroekonomike të institucionit janë të qëndrueshëm.</p>  |





|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.   | Mirëadministrimi i të ardhurave dhe hartimi planeve të detajuara, kanë dhënë mundësi institucionit të ruajë stabilitetin financiar dhe të garantojë realizimin e investimeve të parashikuara në infrastrukturë, laboratorë dhe logjistikën e nevojshme.   |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | <i>Takimi me Zyrën financiare, Ev.7 Tabelat, 14.2</i><br><i>Ev.14.2: Te dhena financiare të UAL për 5 vitet e fundit</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare dhe rritje ekonomike nga viti në vit, pa detyrime ndaj të tretëve individë, organizata, banka apo organe tatimore. Mirëadministrimi i të ardhurave dhe hartimi planeve të detajuara, kanë dhënë mundësi institucionit të ruajë stabilitetin financiar dhe të garantojë realizimin e investimeve të parashikuara në infrastrukturë, laboratorë dhe logjistikën e nevojshme.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  |   | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |   |                              |                             | X                            |

|  |                       |                              |                             |                              |
|--|-----------------------|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b> | <b>Nuk përmbushet</b> | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|  |                       |                              |                             | X                            |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| Standardi V.1   |   |
|---|---|
| <b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</b>  |   |
| Kriteret  | Vlerësimi   |
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.   | Institucioni garanton nëpërmjet statutit të Universitetit “Aldent” dhe Rregulloreve të institucionit, zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br>Prej tyre vijon zbatimi i ligjit në Rregulloren e FSHD, Rregulloren e Departamentit Laborantëve Dentarë, Rregulloren e Programit.<br>Rregullorja e programit përcakton procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve.   |
| <b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.  | Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriterin e mesatares së programit të studimit të nivelit të parë dhe intervistës  |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.      |   |
| <b>Kriteri 4.</b> Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Në institucion pranimi realizohet duke respektuar renditjen në Sistemin U-Albania, sipas pikëzimit. Gjatë kontrollit të dosjeve të studentëve, GVJ evidentoi që dokumentacioni përmbush kriteret e pranimit të studentëve në ciklin profesional të studimeve bazuar në ligjin në fuqi.<br>Kushtet dhe procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve bëhen me dije nga koordinatori i programit. Ndërsa kriteret dhe procedurat e përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përgjegjësi e pedagogëve dhe lehtësohen e mbështeten nga tutori i grupit. (Takim me dekanin, stafin, studentët). Para cdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Staf i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim. |
| <b>Kriteri 5.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.  | <i>Takimi me stafin, studentët, Ev.24.2: Orientimi i maturanteve dhe studentëve Work and Study</i>  |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <b>Kriteri 6.</b> Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Studentët nga trojet apo shtetas të huaj që zotërojnë gjuhën shqipe, kryesisht nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi, Turqia, Greqia etj orientohen për njehësimin e diplomës së shkollës së mesme, plotësimin e detyrimeve të tjera ligjore si edhe për nevoja të tjera të lidhura me qëndrimin e tyre në Shqipëri.<br><br><i>Takimi me stafin, studentët</i>       |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>UAL ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit. UAL deklaron se ndjek një politikë të barabartë pranimi për të gjithë kandidatët qofshin këta me aftësi të veçanta apo përkatësi të ndryshme. Disponon një procedurë për njohjen dhe transferimin e krediteve.</i> |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

#### Standardi V.2

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.**

| <b>Kriteret</b>  | <b>Vlerësimi</b>  |
|--|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | GVJ konstaton se, njohjen me rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës e kryen përgjegjësi i programit i cili e ka detyrim institucional.<br><br>Referuar RVB-së kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve përcaktohen në Rregulloren e UAL dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati prej studimeve të mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit.<br><br>Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulën, ditën e parë të mësimit. |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.                    | Në fillim të ciklit të studimeve, cdo fillim viti, por edhe në cdo moment, studentëve dhe të interesuarve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjigjesit të programit. Veprimtaria informuese intensifikohet në muajin shtator si periudhë informuese.   |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.  | Studentët e UAL informohen për të gjitha nëpërmjet platformës elektronike FxEducation që është një sistem i brendshëm menaxhimi të  |
| <b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit  |   |

|   |  |                              |                             |                              |
|---|--|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.  | dhënash ku studentët logohen individualisht me të dhënat e tyre personale dhe mund të marrin çdo informacion që lidhet me performancën e tyre akademike. Në këtë sistem ata futen nëpërmjet faqes zyrtare të Universitetit ALDENT në rubrikën “portal i studentit” në çdo kohë dhe nga çdo pajisje elektronike e lidhur në internet. <a href="http://portalionline.ual.edu.al/">http://portalionline.ual.edu.al/</a> . |                              |                             |                              |
| <b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | <i>Takimi me studentët, Ev:24.3 Fletëpalosje informuese, 24.4 Reklama e UAL</i>  |                              |                             |                              |
| <b>Konkluzione</b>  | <i>Universiteti Aldent ka struktura të ngritura për dhënien e informacionit të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në këtë program studimi. Përgjegjësi i programit, tutori akademik dhe struktura të tjera përfshihen në procesin e informimit dhe orientimit të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimit.</i>               |                              |                             |                              |
| <b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>  | <b>Nuk përmbushet</b>  | <b>Përmbushet pjesërisht</b> | <b>Përmbushet kryesisht</b> | <b>Përmbushet plotësisht</b> |
|   |  |                              |                             | X                            |

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.**

| Kriteret  | Vlerësimi   |
|---|---|
| <b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.                                      | GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga përgjegjësi i programit si dhe në faqen zyrtare të institucionit. <i>Takimi me stafin, studentët</i>  |
| <b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u vihet në dispozicion katalogu i shkollës, si dhe tabelat informuese në auditoret e leksioneve. Ata mund të marrin informacion edhe nga përgjegjësi i programit dhe tutori akademik në lidhje me veprimtaritë formuese.<br><br>Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale për të rritur potencialin dhe për t'u mirëorientuar në tregun e punës, nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentë e të diplomuar për ndjekjen e |
| <b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.                  |   |



|  |  |                                     |                                    |  |
|--|--|-------------------------------------|------------------------------------|--|
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>   | <p>karrierës së tyre profesionale.</p> <p>Nëpërmjet platformës Fx Education, si sistem i brendshëm i menaxhimit të të dhënave, studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht edhe në distancë me rezultatet e tyre gjatë procesit mësimor.</p> <p>Sekretaria mësimore disponon të gjithë dokumentacionin e duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike.</p>   |                                     |                                    |  |
| <p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p> | <p>Përveç dokumentacionit fizik të nënshkruar (proçesverbalet, regjistrat) rezultatet e studentëve disponohen edhe në formë elektronike në platformën FxEducation.</p> <p>Puna e sekretarisë mësimore është në monitorim të vazhdueshëm nga administratori i institucionit në kuadër të hierarkisë dhe mbikqyrjes. <i>Takimi me stafin, studentët, Ev. Ev.24.1 : Rregullore e Zyres se Karrieres</i></p>   |                                     |                                    |  |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale për të rritur potencialin dhe për t'u mirëorientuar në tregun e punës, nëpërmjet Zyres së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Studentët logohen individualisht dhe njihen lehtësisht edhe në distancë me rezultatet e tyre gjatë procesit mësimor.</i></p> |                                     |                                    |  |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p><b>Nuk përmbushet</b></p>   | <p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përmbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p> |

**Standardi V.4**

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p> | <p>Institucioni disponon në sekretarinë mësimore, statistikat vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për cdo program studimi.</p> <p>Referuar vizitës në sekretarinë mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për dy vitet akademike ishte:</p> <p>Për vitin akademik 2021 – 2022, 28 studentë;<br/>Për vitin akademik 2022– 2023, 18 studentë;</p> <p>Universiteti, disponon gjithashtu, dokumentacionin vjetor me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit profesional “Asistencë Dentare”. Informacioni ruhet në kohë reale dhe</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Të dhënat statistikore të</p>  |  |

|  |   |                              |                             |                              |
|--|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>   | <p>menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore, nëpërmjet Fx Education. Përveç ruajtjes së këtyre të dhënave në sistem online, shënohen manualisht të gjitha në regjistrat themeltar të programit të studimit.</p> <p>Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education.</p> <p>Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte të sigurisë së plotë, kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin persona të autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mësimore,) dhe mund të hyjnë pa të drejtë manipulimi, një kategori e caktuar personash të autorizuar. (Vizitë në sekretarinë mësimore).</p> <p>Referuar RVB-së, institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës, për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Në këtë raport analizohet edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjerohen masa për përmirësimin e cilësisë.</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njërive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p> | <p><i>Takimi me sekretarinë</i></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>   |   |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>UAL vërteton se disponon në sekretarinë mësimore, statistikat vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për cdo program studimi. Të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike në platformën Fx Education. Përveç ruajtjes së këtyre të dhënave në sistem online, shënohen manualisht të gjitha në regjistrat themeltar të programit të studimit.</i></p>   |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>  | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|  |   |                              |                             | X                            |

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

| Kriteret                                  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon | Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe |




|   |   |                              |                             |                              |
|---|---|------------------------------|-----------------------------|------------------------------|
| <p>përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>  | <p>Rregulloret e institucionit, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UAL.</p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>                                  | <p>Studentët organizohen në Senatin Studentor, me një senator për çdo grup mësimor si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si NJSBC, komisioni i kurrikulave, GVB, komisioni i kërkimit shkencor. Zëri dhe përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohet me pjesëmarrjen e tyre në komisione organe dhe komisione të rëndësishme si NJSBC, komisioni i kurrikulave, komisioni i kërkimit shkencor, etj. Pyetësi i studentëve është një mënyrë tjetër ku ata mund të japin opinionin e tyre në mënyrë anonime dhe rreth çdo problematike që lidhet me institucionin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor.</p> |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p> | <p>Studentët kanë të përshkruara të drejtat e tyre në dokumentat rregullatorë dhe ato respektohen me rigorozitet nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.</p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>                     | <p><i>Ev.12.5 : Rregullore e Këshillit studentor, Ev:12.2 Rregullore e sekretarisë</i></p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Konkluzione</b></p>   | <p><i>Studentët në UAL deklarojnë se përfshihen në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore nëpërmjet përfaqësuesve të tyre nga Senati studentor. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit me qëllim komentimin e rezultatit dhe kanë të drejtë të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.</i></p>  |                              |                             |                              |
| <p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>   | <p>Nuk përmbushet</p>   | <p>Përmbushet pjesërisht</p> | <p>Përmbushet kryesisht</p> | <p>Përmbushet plotësisht</p> |
|   |   |                              |                             | <p>X</p>                     |

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.**

| Kriteret  | Vlerësimi  |
|---|--|
| <p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>   | <p>Nga RVB si dhe nga takimet me zyrat përkatëse konstatuam se Zyra e Këshillimit të karrierës në institucion në bashkëpunim me përgjegjësit e programeve merr përsipër:</p> <p>Informimin e studentët e ardhshëm në lidhje me programet e studimit, standardet e pranimit të UAL-së dhe prespektivën personale e profesionale në përputhje me kërkesat dhe kriteret e vendosura nga Ministria e Arsimit.</p> <p>Informimin e studentëve dhe këshillimin e tyre që në momentin e regjistrimit me çdo informacion në lidhje me programet e studimit të ofruara ne Universitetin Aldent.</p> <p>Avantazhet që secili prej programeve ofron si dhe mundësitë e punësimit në tregun e punës në përputhje me rregulloren e Zyrës së Këshillimit të Karrierës.</p> |
| <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>  | <p>Nën përgjegjësinë e departamenteve organizohen aktivitete të tutoriatit për studentët. Në veprimtaritë e tutoriatit përfshihet i gjithë personeli akademik i programit të studimit. Tutorimi akademik përmbledh tërësinë e angazhimeve të tutorëve me student individual ose me grupe studentësh, mbi bazën e akordeve paraprake midis tyre. Shërbimi i tutoriatit synon mbështetjen e studentëve për parandalimin e largimeve apo zgjatjen e kohës së studimeve përtej kohëzgjatjes normale të tyre, i orienton dhe i asiston studentët gjatë gjithë programit të tyre të studimit dhe nxit për një pjesmarrje më aktive të tyre në jetën universitare në të gjitha fushat dhe format e saj.</p> <p><i>Ev.12.6: Rregullore e Tutoriatit</i></p>          |
| <p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p> | <p>Aktivitetet që zhvillohen në kuadër të mbështetjes dhe këshillimit të studentëve nga Zyra e këshillimit të karrierës në mënyrë të vazhdueshme përfshijnë:</p> <p>Leksione të hapura mbi “Metodat efektive të mësimnxënies”, vworkshope “Hapat psikologjikë të menaxhimit të stresit para provimeve”.</p> <p>Projekti: “Fuqizo punësimin tënd” si pjesë e projektit të Këshillit të Europës i quajtur “ENTER”, përgjatë të cilit trajtohet e gjithë pjesa teorike dhe praktike në lidhje me ndërtimin e instrumentave të kërkimit të një vëndi punë si: përgatitja e një kërkese, përgatitja e nje CV-je, e një letre motivimi. Gjithashtu edhe përgatitja për intervistën e parë të punës, të gjithë komponentët të cilët duhen vlerësuar.</p>            |
| <p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës</p>  | <p>Për studentët në prag diplomimi dhe studentët Alumni informohen dhe</p>   |





|  |  |                                    |                                   |                                    |
|--|--|------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| <p>ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse</p> | <p>mbështeten nga kjo njësi përmes këtyre aktiviteteve :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshillim individual i karrierës.</li> <li>- Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminareve, konferencave të Alumnëve dhe studentëve aktualë.</li> <li>- Ndjekjen hap pas hapi e karrierës së të punësuarve përmes krijimit të një database me informacionin e tyre personal, kontaktet dhe vendin e punësimit. Gjithashtu formë tjetër e ruajtjes së kontakteve është edhe faqja në rrjetet sociale e emërtuar Alumni Aldent.</li> </ul> <p><i>Ev 24.1: Rregullore e Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i></p> |                                    |                                   |                                    |
| <p><b>Konkluzione</b></p>  | <p><i>Zyra e Këshillimit të Karrierës në institucion në bashkëpunim me përgjegjësit e programeve merr përsipër orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave gjatë viteve të studimit. Nën përgjegjësinë e departamenteve organizohen aktivitete të tutoriatit për studentët. Për studentët në prag diplomimi dhe studentët Alumni informohen dhe mbështeten nga Zyra e informimit dhe zhvillimit të karrierës përmes aktiviteteve të ndryshme si dhe ruan një database me informacionin personal, kontaktet dhe vendin e punësimit të studentëve pas diplomimit.</i></p>                 |                                    |                                   |                                    |
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>   | <p><b>Nuk përbushet</b></p>  | <p><b>Përbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përbushet plotësisht</b></p> |
|  |  |                                    |                                   | X                                  |

|   |                             |                                    |                                   |                                    |
|---|-----------------------------|------------------------------------|-----------------------------------|------------------------------------|
| <p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V</b></p> | <p><b>Nuk përbushet</b></p> | <p><b>Përbushet pjesërisht</b></p> | <p><b>Përbushet kryesisht</b></p> | <p><b>Përbushet plotësisht</b></p> |
|   |                             |                                    |                                   | X                                  |



**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në “Asistencë dentare” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aldent”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**


1. UAL mundëson praktikë me pacient real në klinikën universitare ku punojnë në bashkëpunim me studentët e stomatologjisë.
2. Infrastruktura moderne siguron njohjen e asistentëve me aparaturat më të sofistikuar dhe përdorimin e tyre në kuadër të praktikës profesionale.
3. Stafi akademik i specializuar me eksperiencë në fushat mjekësive është një vlerë e shtuar për këtë program të formimit profesional.
4. Hapja e këtij program specifik në fushën e asistencës dentare përmirëson shërbimin e ofruar në klinikat dentare.
5. Orari mësimor i favorshëm, vetëm paradite stimulonte studentët të punosoheshin që në vitet e shkollës pasi kërkesat e treguat janë në rritje për këtë profesion.

**Pika të dobta:**

1. Shfrytëzim i ulët i literaturës së huaj online nga studentët e këtij cikli.

**Rekomandime:**

1. Të shikohet mundësia e realizimit të trajnimeve ekstrakurrikulare për studentët duke qenë se programet e shkembimit nuk i përfshijnë programet profesionale të studimit.



**Evaluation's conclusions for the professional study program " Dental Assistant" provided by the Higher Education Institution "Aldent University"**

**Strengths and affirmations:**

1. UAL enables practice with real patients in the university clinic where they work in collaboration with dentistry students.
2. The modern infrastructure ensures that the dental assistants are familiar with the most sophisticated devices and they learn how to use them in the professional practice.
3. The specialized academic staff with experience in the fields of medicine is an added value for this professional study program.
4. The opening of this specific program in the field of dental assistance improves the service provided in our dental clinics.
5. The favorable teaching schedule, only in the morning, stimulated students to work during their school years since the demands of the labor market are increasing for this profession.

**Weaknesses:**

1. Low utilization of online foreign literature by students of this cycle.

**Recommendation:**

1. Looking at the possibility of realizing extracurricular training for students, because exchange programs do not include professional study programs.



**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT   | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS |                       |                      |                       |
|---|--|-----------------------|----------------------|-----------------------|
|   | Nuk përmbushen                                 | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| <b>I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>  |  |                       |                      | X                     |
| <b>II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL</b>            |  |                       |                      | X                     |
| <b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>   |  |                       |                      | X                     |
| <b>IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b> |  |                       |                      | X                     |
| <b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>   |  |                       |                      | X                     |
| <b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>  |  |                       |                      | X                     |

